



**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**  
**DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT**

**MODELE TESTESH PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

**(Teste të hartuara nga mësuesit)**

**LËNDA: MATEMATIKË**



**TETOR, 2019**

## I. NË VEND TË HYRJES

Një nga komponentët më të rëndësishëm të zbatimit të kurrikulës me kompetenca në lëndën e matematikës është vlerësimi i nxënësit dhe veçanërisht vlerësimi nëpërmjet testeve që mësuesi zhvillon në klasë. Është shumë e rëndësishme që testet të hartohen sipas parimeve përkatëse, të përmbajnë disa lloje pyetjesh të cilat zhvillojnë aftësitë kryesore dhe kompetencat matematikore, të përmbajnë situata praktike nga jeta reale etj., si dhe të trajtohen si aspekt i rëndësishëm i procesit të mësimdhënie - nxënies dhe të integruara në “rutinën” e klasës.

Modelet e testeve nga mësuesit për mësuesit bazohen në udhëzuesit kurrikularë lëndore të lëndës së matematikës për AMU-në dhe AML-në dhe janë teste apo pyetje të cilat mund të përdoren në teste të ndryshme. Këto modele janë hartuar **nga vetë mësuesit**, nuk janë teste të standardizuara, por janë përpjekje e mësuesve për të zbatuar parimet e kurrikulës me kompetenca. ASCAP-i ka përzgjedhur disa modele të cilat mund t’ju vijnë në ndihmë mësuesve të tjerë dhe ka ruajtur origjinalitetin për secilin nga testet.

## II. PJESA E PARË – ARSIMI FILLOR

**Testi 1 koha 45 min, klasa IV, mësuese Albana Brahja, shkolla “Edit’h Durham”, Tiranë**

Konceptet	Përqindja - pikë	Rezultatet e të nxënës. Nxënësi :	Niveli II i arritjes së kompe.	Niveli III i arritjes së kompe.	Niveli IV i arritjes së kompe.
<b>Numri; Interpretimi i veprimeve matematikore</b>	55 %	<ul style="list-style-type: none"><li>• kryen veprimet matematikore;</li><li>• gjen shumëfishat e një numri të dhënë;</li><li>• kryen shumëzimet dhe pjesëtimet në shtyllë;</li><li>• zgjidh situatë problemore duke zbatuar shumëzimin dhe pjesëtimin.</li></ul>	U 1  U 2  U 3	U4 U5	U 5
<b>Gjeometri; Drejtëza e simetrisë; Pikat në rrjetin koordinativ</b>	18 %	-dallon dhe ndërton drejtëzën e simetrisë në figurat e dhëna; -përdor koordinatat për të përcaktuar vendndodhjen e një figure në rrjetin koordinativ.	U 6 U7	U 7	
<b>Numri thyesor; Veprime me thyesat;</b>	32%	-kryen veprimet me thyesat; - mbledh, zbret thyesat me emërues të njëjtë;	U 8	U 9 U 11 U 12	U 10  U 13

<b>Numrat e përzier</b>		- kthen një thyesë më të madhe se 1 në numër të përzier; - zgjidh problema me thyesa mbi gjetjen e pjesës së një numri.			
	100% = 37pikë		40% 13 pikë	40% 14 pikë	20 % 8 pikë


Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-8	9 - 13	14 - 18	19 -23	24 -28	29 - 33	34 -37

- E vërtetë apo e gabuar. Përcaktoni. (4 pikë)
  - Cilindri është figurë gjeometrike. V G
  - Zbritja është veprim i kundërt i shumëzimit. V G
  - $4 + 4 + 4 = 3 \times 4$  V G
  - Shumëfishat e dyshit janë numra çift. V G
- Qarkoni me të kuqe shumëfishat e 4-ës dhe me blu shumëfishat e 10-ës (2 pikë)  
30, 17, 35, 21, 71, 12,
- Kryeni veprimet në shtyllë. (2 pikë)  
 $16 \times 3 =$  ;  $17 \times 5 =$ ;
- Pjesëtoni. Gjjeni herësin dhe mbetjen. Bëni provën. (4 pikë)
 

$96 : 7 =$	$72 : 7 =$
H:	H:
M:	M:
Prova:	Prova:
- Prodhimit të 18-ës me 3-shin zbritini herësin e 91-shit me 7-ën. (6 pikë)
  - Shënoni numrin në radhën e veprimeve:  

zbritje	shumëzim	pjesëtim
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
  - Kryeni veprimet:  

.....
- A kanë figurat e dhëna drejtëza simetrie? Shënoni me PO ose JO. (2 pikë)  
Nëse kanë, vizatojini ato.




.....

.....

7. Përdorni të dhënat për të ndërtuar figurën në rjetin koordinativ. (4 pikë)

- A) (1,3)
- B) (1,2)
- C) (1,6)
- D) (4,3)



8. Qarkoni përgjigjen e saktë. (1 pikë)

- A)  $\frac{4}{6} \leq \frac{3}{6}$
- B)  $\frac{5}{9} \geq \frac{3}{9}$
- C)  $\frac{2}{8} \geq \frac{5}{8}$
- D)  $\frac{1}{2} = \frac{2}{4}$

9. Ktheni thyesat në numra të përzier. (2 pikë)

a.  $\frac{7}{4} = \dots\dots\dots$     b.  $\frac{10}{3} = \dots\dots\dots$

10. Mblidhni dhe zbrisni thyesat. (4 pikë)

$\frac{2}{5} + \frac{2}{5} = \dots\dots$      $\frac{3}{19} + \frac{4}{19} + \frac{7}{19} = \dots\dots$      $\frac{6}{8} - \frac{2}{8} = \dots\dots$      $\frac{13}{15} - \frac{8}{15} = \dots\dots$

11. Një apartament me 5 dhoma, duhet ta lyeni për 3 ditë. Si do të veproni për ta lyer apartamentin në kohë. Sqaroni zgjedhjet tuaja. (2 pikë)

.....

12. Andia ka 7 gjysma mollësh. Sa personave mund t'ju japë nga një mollë të plotë ajo? (1 pikë)

13. Megi mblodhi 49 lule. Me  $\frac{3}{7}$  e tyre bëri një kurorë. Lulet që i mbetën ua ndau 4 shoqeve në mënyrë të barabartë. Sa lule mori secila nga shoqet ? (3 pikë)

**Klasa IV Testi 2 koha 45 min, mësuese Albana Brahja, shkolla “Edit’h Durham”, Tiranë**

Konceptet	Përqindja - pikë	Rezultatet e të nxënit. Nxënësi :	Niveli II i arritjes së kompe.	Niveli III i arritjes së kompe.	Niveli IV i arritjes së kompe.
<b>Numrat dhjetorë dhe thyesat dhjetore</b>	15%	-lidh numrin dhjetor me shënimin përkatës; -përcakton numrin dhjetor midis dy numrave dhjetorë; -paraqet në boshtin numerik numrat dhjetorë.	U 1 U 2 U 3	U4	
<b>Njësitë e matjes së kohës, gjatësisë dhe masës</b>	46%	-rendit masat e dhëna sipas rendit rritës; -kthen njësitë e matjes; -dallon njësinë e matjes së një objekti; -kryen veprime me njësitë e matjes.	U 5 U 7	U 6 U 8 U 9	U 9 U 10 U 11
<b>Paraqitja dhe interpretimi i të dhënave</b>	34 %	-plotëson tabelën e dendurisë në një grup të dhënash; -paraqet të dhënat me tabelë me diagram me shtylla; -interpretë informacionin e dhënë nga një diagram me shtylla.	U 12/a	U 12/ b	U 12/c
	100% 37 pikë		40% 14pikë	40% 14 pikë	20 % 9 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-8	9 - 13	14 - 18	19 -23	24 -28	29 - 33	34 -37

1. Qarkoni, me cilin shënim është i njëjtë numri 0,4. (1 pikë)


- A) katër
- B) katër të dhjetat
- C) katër të qindat
- D) një e katërta

2. Në numrat e mëposhtëm, gjyrosniata që ndodhen ndërmjet 2,6 dhe 2,8. (1 pikë)


0,7 2,5 2,9 2,7 1,7

2. Vendosni në boshtin numerik numrat dhjetorë. (2 pikë)

1,7                                  0,7



3. Lidhni me vijë thyesat me numrat dhjetorë. (2 pikë)




4. Renditni masat nga më e lehta te më e rënda. (2 pikë)

6,9 kg ;      2,5 kg ;                  12,1 kg ;      8,9 kg ;      12,4 kg

..... , ..... , ..... , ..... , .....

5. Sa mililitra ka në një litër ? ..... mililitra (1 pikë)

6. Lidhni me shigjetë alternativën e duhur. (1 pikë)



7. Përcaktoni, e vërtetë apo e gabuar. (4 pikë)

- |  |   |   |
|--|---|---|
| a. Për të matur masën e një trupi përdorim metrin.             | V | G |
| b. Për të matur sasinë e ujit në depozitë përdorim mililitrin. | V | G |
| c. Për të matur masën e një lapsi përdorim centimetrin.        | V | G |
| d. Për të matur masën e trupit tonë përdorim kilogramin.       | V | G |

8. Kryeni veprimet. (5 pikë)

$$\begin{array}{r}
 + \quad 16 \text{ kg } 230 \text{ g} \\
 \hline
 \quad 5 \text{ kg } 430 \text{ g} \\
 \hline
 \end{array}
 \quad
 \begin{array}{r}
 - \quad 19 \text{ kg } 200 \text{ g} \\
 \hline
 \quad 7 \text{ kg } 400 \text{ g} \\
 \hline
 \end{array}
 \quad
 \begin{array}{r}
 + \quad 4 \text{ m } 16 \text{ cm} \\
 \hline
 \quad 7 \text{ m } 89 \text{ cm} \\
 \hline
 \end{array}
 \quad
 \begin{array}{r}
 - \quad 6 \text{ dm } 3 \text{ cm} \\
 \hline
 \quad 4 \text{ dm } 8 \text{ cm} \\
 \hline
 \end{array}
 \quad
 \begin{array}{r}
 + \quad 61 \text{ } 600 \text{ ml} \\
 \hline
 \quad 21 \text{ } 455 \text{ ml} \\
 \hline
 \end{array}$$

9. Megi doli nga shtëpia për një shëtitje në orën 09: 00. (2 pikë)


Nëse shëtitja e saj zgjati 1 orë e 30 minuta, në cilën orë e mbaroi ajo shëtitjen?

\_\_\_\_\_

10. Vizatoni segmentin  $[AB] = 8.5$  cm. Vizatoni segmentin  $[CD]$  2 cm më të shkurtër se segmenti  $[AB]$ .

Sa është gjatësia e dy segmenteve së bashku? (2 pikë)

11. Në boshtin numerik më poshtë, qarkoni numrin më të madh me ngjyrë të kuqe dhe numrin më të vogël me ngjyrë blu. (2 pikë)




12. Në klasën IV-A u zhvillua një anketë për frutin më të pëlqyer. (12 pikë)

U grumbulluan këto të dhëna: 7 nxënës pëlqejnë bananet, 6 nxënës pëlqejnë portokallet, 9 nxënës pëlqejnë qershitë, 5 nxënës pëlqejnë kivin dhe 3 nxënës pëlqejnë mollët.

a) Paraqitni të dhënat në tabelën e dendurisë. b) Paraqitni të dhënat me diagram me shtylla

Fruti	Denduria
Banane	
Portokalle	
Qershi	
Kivi	
Mollë	



Në anketim morën pjesë ..... nxënës.

c) Plotësoni :


- Cili është fruti më i pëlqyer ? .....
- Cili frut është më pak i pëlqyer?.....
- Sa nxënës pëlqejnë më shumë qershitë se mollët? .....

Klasa V Testi 3 koha 45 min, mësuese Albana Brahja, shkolla “Edit’h Durham”, Tiranë

Konceptet	Përqi ndja - pikë	Rezultatet e të nxënit. Nxënësi :	Niveli II i arritjes së kompe.	Niveli III i arritjes së kompe.	Niveli IV i arritjes së kompe.
(Numri) Interpretimi i veprimeve matematikore	85% →	- formimi i numrave katër shifror. - lidh numrat e dhënë me shifra me numrat e dhënë me fjalë; - përcakton vlerën e secilës shifre të numrit; - dallon klasën e thjeshtë nga klasa e mijësheve; - rendit në rendin zbritës, rritës; - rumbullakos numrat me afërsi 10, 100 dhe 1000 ; - mbledh e zbret numrat katër shifrorë me kalim dhe prishje të rendeve ; - gjen sh.v.p.-në e dy a më shumë numrave ; - shumëzon numrat dyshifrorë; - zgjidh situatë problemore me veprimet matematikore.	U 1  U 3    U 5   U 8  U 12	   U 2  U4   U 6   U 7 U 13	U 7         U 14
(Gjeometri) Drejtëza e simetrisë ; Pikat në rrjetin koordinativ	15%	-përcakton llojet e drejtëzave; -dallon dhe emërton llojet e këndeve; - vizaton kënde me masë të përcaktuar.	U9	U 11	U 10
	100% 40pikë		40% 16 pikë	40% 16 pikë	20 % 8 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0 - 9	10-15	16 - 20	21 - 25	26 -30	31 - 35	36 - 40

1. Me shifrat e dhëna formoni numrin më të madh katër shifror dhe numrin më të vogël katër shifror. (3 pikë)



Numri më i madh ..... Numri më i vogël .....

Gjeni ndryshesën e tyre. ....



2. Tregoni vlerën e shifrës së vijëzuar. (3 pikë)

35897 → .....

A ndryshon numri nëse ndërtoni vendin e dhjetësheve me njëshet? \_\_\_\_\_

Cilin numër formuat? .....

3. Lidhni me shigjetë numrat e dhënë me shifra me numrat e dhënë me fjalë. (3 pikë)

32 886	tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesë
36 805	dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë
259 345	tridhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë.

4. Përgjigjuni pyetjeve në lidhje me numrat e mëposhtëm. (4 pikë)

3 204; 31 526; 149 491


- A e kanë të gjithë numrat klasën e thjeshtë? .....
- Sa shifra ka klasa e thjeshtë? .....
- A mund të jenë ato zero? .....
- A kanë numrat të njëjtën numër shifrash? .....

5. Renditni në rendin zbritës numrat e dhënë. (1 pikë)

13 618; 28 761; 12 356; 28772; 17 279; 28 672

..... ; ..... ; ..... ; ..... ; .....

6. Rrumbullakosni numrin me afërsi 10, 100, 1000, (3 pikë)



7. Jona do të shkruante në pentagram notat muzikore të tri këngëve.

Ditën e parë shkroi një këngë me 3 714 nota muzikore në 20 pentagrame.

Ditën e dytë shkroi një këngë me 4 829 nota muzikore në 25 pentagrame. Kënga e ditës së tretë kishte 130 nota muzikore më pak.

Çfarë të dhënash i duhen Jonës për të gjetur se sa nota muzikore shkroi për të tria këngët ?

(2 pikë)

\_\_\_\_\_

Gjeni, sa nota muzikore shkroi në këngën e ditës së tretë ? (1 pikë)

\_\_\_\_\_


A mund të gjeni në sa pentagrame i shkroi të tria këngët? \_\_\_\_\_ (1 pikë)

Argumentoni përgjigjen. \_\_\_\_\_ (2 pikë)

8. Kryeni veprimet në shtyllë. (2 pikë)

$2\,429 + 4\,618 =$                        $8\,207 - 1\,099 =$


9. Lidhni drejtëzat me emërtimin e saktë. (3 pikë)



Pingule



Prerëse



Paralele

10. Vizatoni këndin  $75^\circ$ . (2 pikë)

Emërtoni llojin e tij. ....

11. Vrojtoni trekëndëshat. Ngjyrosni emërtimin e tyre. (2 pikë)



Kënddrejtë  
Këndgjerë  
Këndngushtë



Dybrinjënjëshëm  
Barabrinjës  
I çfarëdoshëm /

Brinjëndryshëm

12. Gjeni: (3 pikë)

Numrat	3, 8	2, 4, 7	4, 8
Sh.v.p.			

13. Shumëzoni në shyllë (shkurt). (2 pikë)

$18 \times 47 =$                        $32 \times 68 =$

14. Ana shpenzoi 298 lekë. Nëna e saj shpenzoi 3-fishin e lekëve të Anës.Tani, nënës i mbetën 529 lekë.Sa lekë kishte në fillim nëna? (3 pikë)

**Klasa V Testi 4, koha 55 min, mësuese Albana Brahja, shkolla “Edit’h Durham”, Tiranë**

Konceptet	Përqindja - pikë	Rezultatet e të nxënit. Nxënësi :	Niveli II i arritjes së kompe.	Niveli III i arritjes së kompe.	Niveli IV i arritjes së kompe.
(Numri)	79%	-dallon numrat që plotëpjesëtohen me numrin e dhënë;	U 1	U 3	U4

		-gjen dyfishin dhe përgjysmon numrat; -zgjidh shprehje aritmetike me dhe pa kllapa; - përcakton numrat e përzier për thyesat e parregullta; - gjen pjesën e një numri të dhënë; -kryen veprime me numrat dhjetorë; - gjen herësin dhe mbetjen e numrave;	U 2    U 12	U 6 U 7  U 11	U 8  U 10  U 13
( Matjet )	3 %	-zgjidh situatë problemore me njësitë e kohës.		U 5	
( Gjeometri )	18%	-vizaton figurat simetrike në lidhje me drejtëzën e simetrisë; - përcakton koordinatat e pikave në rrjetin koordinativ.	U 9 /A	U 9 U 12	U 9
	100%				

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0 -10	11-16	17 - 22	23 - 28	29 - 34	35 - 39	40 - 44

1. Qarkoni me të kuqe numrat që plotëpjesëtohen me 2 dhe me blu numrat që plotëpjesëtohen me tre. (2 pikë)

16 98, 25, 45, 522, 111 , 729 , 297 .

2. Plotësoni tabelën me vlerat: (6 pikë)

numri	2-fishi i numrit	gjysma e numrit
	36	
320		
		600

3. Ndërtoni shprehjen: (2 pikë)

Numrit 42 shtoi herësin e 63 me 7 dhe më pas zbriti prodhimin e 12 me 2.

Gjej vlerën e shprehjes.

4. A është e saktë vlera e shprehjes? (2 pikë)

$$15 : ( 3 \times 5 ) + ( 3 \times 5 ) = 15 \quad \underline{\hspace{2cm}}$$

Trego përse mendon kështu.

5. Megi filloi të lexonte një libër në orën 9:45. (2 pikë)

Pasi mbaroi së lexuari, ajo pa se ora shënonte 11:50.

Sa kohë shpenzoi ajo me leximin e librit ?

.....

6. Lidhni me shigjetë thyesat e parregullta me numrat e përzier. (3 pikë)

$4\frac{1}{6}$	$\frac{13}{3}$
$6\frac{6}{7}$	$\frac{48}{7}$
$4\frac{1}{3}$	$\frac{25}{6}$

7. a. Gjeni numrin e tullumbaceve që u lëshuan në ajër kur dimë që: (1 pikë)

$\frac{1}{4}$  e 48-të tullumbaceve u lëshuan në ajër.

.....

b. Gjeni numrin e frutave u dërguan për reçel kur dimë që: (1 pikë)

$\frac{2}{6}$  e 480-të kg të frutave u dërguan për reçel.

.....

8. Ditën e parë u paketuan  $\frac{3}{8}$  e librave. Ditën e dytë u paketuan  $\frac{4}{8}$  e tyre.

A u paketuan të gjithë librat për dy ditë? ..... (2 pikë)

Ç'pjesë e tyre mbeti? .....

Si mendoni, sa pako u formuan? \_\_\_\_\_ (2 pikë)

Pse mendoni kështu? \_\_\_\_\_ (1 pikë)


9. Ndërtoni rrjetin koordinativ.

- Vizatoni figurën simetrike të trapezit ABCD në lidhje me drejtëzën e simetrisë d. (1 pikë)

- Emërtoni trapezin që vizatuat  $A_1 B_1 C_1 D_1$ . (1 pikë)

- Plotësoni tabelën me koordinatat e pikave. (4 pikë)

A ( , )	B ( , )	C ( , )	D ( , )
$A_1$ ( , )	$B_1$ ( , )	$C_1$ ( , )	$D_1$ ( , )



10. Plotësoni me numra dhjetorë.

(4 pikë)

$$0,3 + \dots = 1$$

$$0,83 + \dots = 1$$

$$1 - \dots = 0,7$$

$$1 - 0,92 = \dots$$

11. Kryeni veprimet.

(3 pikë)

$$2,13 + 2,14 =$$

$$8,95 - 4,64 =$$

$$5,2 \times 4 =$$

c- Gjeni herësin dhe mbetjen e numrave.

(2 pikë)

$$950 : 8 =$$

$$7463 : 9 =$$

d- Bora, për një javë, shpenzon 2 499 lekë për mjetet e saj të pikturës. Vëllai i saj shpenzon 3 herë më pak se Bora për ëmbëlsirat e tij për një javë.

Sa lekë shpenzojnë motër e vëlla për një javë?

(1 pikë)

Si mendoni, a u dalin atyre 3 330 lekë në një javë? \_\_\_\_\_

(2 pikë)

Pse mendoni kështu?

---



---



---

Sugjerojini Borës dhe vëllait të saj se si mund të veprojnë.

(2 pikë)

---



---



---

### III. PYETJE QË MUND TË PËRDOREN NË TESTE NË ARSIMIN FILLOR

Klasa IV, mësuese Blerta Buzo, shkolla “St.Zoot.Xhafzotaj”, Durrës

1. Shëno me V, e saktë dhe me G, e gabuar. 3 pikë

\_\_\_ E përdorim veprimin e shumëzimit në rast se duam të zëvendësojmë një mbledhje të përsëritur.

\_\_\_ Kufizat e shumëzimit quhen faktorë dhe përfundimi herës.

\_\_\_ Kur duam të gjejmë “Sa herë më pak” përdorim veprimin e pjesëtimit.

2. Shëno me PO dhe JO. 3 pikë

\_\_\_ Çdo figurë ka drejtëz simetrie.

\_\_\_ Drejtëza e simetrisë e ndan figurën në dy pjesë që puthiten.

\_\_\_ Katrori ka dy drejtëza simetrie.

3. Shoqëro me shigjetë mjetin me njësinë matëse. 4 pikë

Metri

Peshorja

Ora

Vëllimi

Litri

Minuta

Centimetri

Kilogrami

4. Lidh veprimin me vetitë që ai ka. 3 pikë

Mbledhja

Vetia e ndërrimit
Vetia e pandryshueshmërisë
Vetia e shoqërimit

5. Cila nga alternativat është e saktë me  $\frac{7}{10} - \frac{2}{10}$ ? Qarko alternativën e saktë: 1 pikë

A)  $\frac{2}{10} + \frac{3}{10}$

B)  $\frac{5}{10} + \frac{4}{10}$

C)  $\frac{7}{10} + \frac{2}{10}$

6. Cili numër është shumëfish i 7-ës? Qarko alternativën e saktë: 1 pikë

A) 27

B) 48

C) 56

D) 74

7. Plotëso. 4 pikë

Kur pjesëtojmë, jo gjithmonë mbetja është \_\_\_\_\_.

Çdo numër, i pjesëtuar me veten, jep \_\_\_\_\_.

Pjesëtimi është veprim i \_\_\_\_\_ i shumëzimit.

0 e pjesëtuar për çdo numër, jep \_\_\_\_\_.

8. Përgjigju pyetjeve: 2 pikë

Kur pika ndodhet në një bosht numerik, sa koordinata na duhen për të gjetur vendndodhjen e saj? \_\_\_\_\_

Si quhen numrat që përcaktojnë vendndodhjen e një pike në rrjetin koordinativ?

\_\_\_\_\_

9. A është e vërtetë që gjysma e gjysmës së 400 librave janë sa dyfishi i 50 librave? 2 pikë  
Pse?

Kryej veprimin \_\_\_\_\_

10. Në dyqanin e frutave  $\frac{2}{7}$  e frutave janë mollë,  $\frac{3}{7}$  janë pjeshkë,  $\frac{1}{7}$  janë dardhë 6 pikë

A ka në dyqan fruta të tjera? \_\_\_\_\_

Në qoftë se po, ç'pjesë përbëjnë ato? \_\_\_\_\_

Sa kg janë mollë në qoftë se dihet që janë gjithsej 140 kg fruta?

\_\_\_\_\_

Sa kg janë dardha në qoftë se dihet që janë gjithsej 140 kg fruta?

\_\_\_\_\_


Sa kg janë pjeshkë në qoftë se dihet që janë gjithsej 140 kg fruta?

\_\_\_\_\_

Sa kg janë fruta të tjera në qoftë se dihet që janë gjithsej 140 kg fruta?

\_\_\_\_\_

11. Një nxënës i klasës IV<sup>A</sup> bëri një anketim me djemtë në klasën e tij dhe të dhënat e grumbulluara i paraqiti me një diagram si ky. (Çdo djalë ka vetëm një preferencë.)



- Vrojto me kujdes diagramin.

a) Sa djem kanë marrë pjesë në anketim? 1 pikë

---

b) Trego se çfarë zbulon nga ky diagram. 1 pikë

---



---

c) Paraqit të dhënat në tabelën e dëndurisë. 3 pikë

Skudrat	Denduria
Interi	
Milani	
Juventusi	

**12.** Teuta vizatoi një diagramë për preferencat e shokëve të saj për lëndët anglisht dhe italisht.

a) Sa prej shokëve të saj pëlqejnë italishten? 1 pikë

---

b) Sa prej shokëve të saj pëlqejnë anglishten? 1 pikë

---

c) Sa prej tyre i pëlqejnë njëkohësisht të dyja? 1 pikë

---


d) Cili nga shokët nuk pëlqen as italishten, as anglishten? 1 pikë

---

e) Si e kuptuat ju që nuk pëlqejnë as italishten, as anglishten? 2 pikë

---





**Klasa IV, mësuese Julinda Bllaca, shkolla “Marie Kaçulini”, Durrës**

1. Rrethoni alternativën e saktë.  $\frac{3}{4}$  e orës është e barabartë me: **1 pikë**

- A) 15 minuta
- B) 30 minuta
- C) 45 minuta
- D) 60 minuta

2. Një makinë ka katër rrota. Sa rrota kanë 9 makina? **1 pikë**

- A) 32
- B) 38
- C) 36
- D) 34

3. Lidh me shigjetë. **3 pikë**

$4 Q + 6 Dh + 3 Nj$	704
$7 Q + 0 Dh + 4 Nj$	590
$5 Q + 9 Dh + 0 Nj$	740
	463

4. Shoqëro me shigjetë faktorët me prodhimet e tyre. **4 pikë**

36	7 x 8
48	9 x 4
54	7 x 7
56	6 x 8
49	

5. Rretho **V** nëse barazimet janë të vërteta dhe **G** nëse janë të gabuara. **4 pikë**

$238 = 2 Q + 3 Dh + 8 Nj$                       V      G

$502 = 5 Q + 0 Dh + 0 Nj$                       V      G

$83 = 8 Dh + 3 Nj$                                 V      G

$53 = 3 Dh + 5 Nj$                                 V      G

6. Plotëso: **3 pikë**

a) Për të gjetur mbledhorin që mungon, nga shuma \_\_\_\_\_ mbledhorin tjetër.

b) Për të gjetur mesataren aritmetike, gjejmë \_\_\_\_\_ e numrave dhe e \_\_\_\_\_ me sasinë e numrave që mbledhëm.

7. Lira bëri një shëtitje nga Kodrat e Liqenit për 3 orë. Në shtëpi u kthye në orën 14:00 pas dreke.

a) Në ç'orë doli Lira për shëtitje? **1 pikë**

b) Supozoni nëse Lira, përveç shëtitjes prej 3 orësh, do të konsumonte dhe një lëng për 30 minuta në një bar. Në cilën orë do të kthehej ajo në shtëpi? **1 pikë**

8. Në klasën IV<sup>B</sup> që kishte 25 nxënës, u zhvillua një anketë: “Cili sport ju pëlqen më shumë: futboli, basketbolli, volejboli, atletika?” 10 nxënës pëlqejnë futbollin, 5 nxënës pëlqejnë basketbollin, 6 nxënës pëlqejnë volejbollin, 4 nxënës pëlqejnë atletikën. **4 pikë**

a) Plotëso të dhënat në tabelën e dendurisë.

Sportet	Denduria
Futboll	
Basketboll	
Volejboll	
Atletikë	

b) Paraqiti të dhënat në diagramin me shtylla **4 pikë**


futboll      basketboll      volejboll      atletikë

- c) Cili është sporti më i pëlqyer? ..... **1 pikë**
- d) Cili është sporti më pak i pëlqyer? ..... **1 pikë**
- e) Sa nxënës pëlqejnë më shumë volejbollin se atletikën? **1 pikë**

**Klasa III, mësuese Valbona Musaj, shkolla “14 Nëntori”, Durrës**

- 1. Shoqëro** **4 pikë**

- 48
- Shumëfish i 6-ës • • 18
- Shumëfish i 7-ës • • 27
- 36
- 21

- 2. Lidh madhësinë me njësinë matëse.** **4 pikë**

- Gjatësia • • kilogrami
- Masa • • litri
- Vëllimi • • gradë
- Koha • • ora
- metri

- 3. Qarko alternativën e saktë Numërori “treqind e katër“ shkruhet me shifra:.** **1 pikë**

- A) 34
- B) 304
- C) 340
- D) 403

4. Cila figurë 2D ka 4 drejtëza simetrie? Qarko alternativën e saktë: 1 pikë

- A) drejtkëndëshi
- B) trapezi
- C) katrori
- D) trekëndëshi

5. Plotëso fjalitë me numrat e duhur. 3 pikë

Çereku është 1 nga \_\_\_ pjesë të barabarta.

Gjysma është 1 nga \_\_\_ pjesë të barabarta.

Treçereku është \_\_\_ nga 4 pjesë të barabarta.

6. Shëno "E vërtetë" për alternativën e saktë dhe "E gabuar" për alternativën e pasaktë. 4 pikë

Kubi ka 6 faqe. \_\_\_\_\_

Piramida i ka faqet anësore në formë drejtkëndore. \_\_\_\_\_

Prizmi ka 1 bazë. \_\_\_\_\_

Cilindri ka 2 kulme. \_\_\_\_\_

7. Në klasën e Erës, në fillim të vitit ishin 28 nxënës. Gjatë vitit, erdhën 4 nxënës të rinj dhe u larguan nga klasa 5 nxënës. Sa nxënës janë në fund të vitit në klasën e Erës? Qarko

alternativën e saktë.

1 pikë

- A) 32 nxënës
- B) 23 nxënës
- C) 27 nxënës
- D) 29 nxënës

8. Kur arka është e mbushur me qershë peshon 24 kg, kur është bosh peshon 2kg. Çfarë veprimi do kryesh për të gjetur sa peshojnë qershitë? Qarko alternativën e saktë 1 pikë

- A)  $24 + 2 = 26$
- B)  $24 : 2 = 12$
- C)  $24 - 2 = 22$
- D)  $24 \times 2 = 48$

9. Shitësi vendosi në një rënë anë të peshores disa dardha dhe në anën tjetër 300g mollë dhe 400g rrush që peshorja të ishte në ekuilibër. Cilat peshojnë më shumë? Qarko alternativën e saktë

1 pikë

A) mollët

B) dardhat

C) rrushi

D) Nuk mund ta gjejmë

Shpjego pse \_\_\_\_\_ 1 pikë

10. Arbri takoi në rrugë Mirin. Ata vendosën që pas 2 javësh, në datën 18 mars të dilnin shëtitje në park.

Sa ishte data kur ata u takuan? \_\_\_\_\_ 1 pikë

Trego si e gjeje. \_\_\_\_\_ 1 pikë

#### IV. PJESA E DYTË – ARSIMI I MESËM I ULËT

Klasa VI Test përmbledhës, periudha 2, koha 45 min, mësuese Aida Sulejmani, shkolla

“Servete Maçi”, Tiranë

Konceptet	%	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Nivelet e arritjes		
<b>Numri</b>	74%		Niv II	Niv III	Niv IV
<b>1-kuptimi i nr.</b>	5 %	-kupton dhe krahason nr. e plotë me anë të paraqitjeve në boshtin numerik.	U 1	U 1	-
<b>2-Veprime me nr.</b>	53%	-mbledh numrat dyshifrorë ose treshifrorë me të njëjtin ose jo numër shifrash; -mbledh dhe zbret numrat dhjetorë me të njëjtin ose jo numër shifrash në pjesën dhjetore; -gjen ndryshesën e numrave pozitivë dhe negativë në boshtin numerik, si dhe në kontekstin e gjetjes së temperaturave; - shumëzon dy numra dyshifrorë, shumëfisha të 10-ës; - shumëzon numra natyrorë katërshifrorë me numra njëshifrorë, si dhe numra dyshifrorë ose treshifrorë me numra dyshifrorë; - pjesëton një nr. katërshifror me nr. Dyshifror; -pjesëton me mbetje, dallon: herësin e saktë të përafërt dhe i shpreh herësat e përafërt në dy mënyra; -përdor veprime matematikore nga situata të jetës reale.	U 2 U 3/a,b,c, d,e U 5	U 6 7/a,b,c	U 7
<b>3- Veprime me mend</b>	16 %	-mbledh dhe zbret me mend numra njëshifrorë dhe dyshifrorë; - mbledh dhe zbret me mend numra dhjetorë me një shifër pas presjes, me shumë 1 shumë 10 - shumëzon dy numra, ku njëri është numër dyshifror, shumëfish i 10-ës dhe tjetri është numër treshifror, shumëfish i 100-ës. - pjesëton numra natyrorë me 2, 4, 5, 10, 25 dhe 100.	4/a,b,c, d		
<b>Gjeometri në plan dhe hapsirë</b>	26%				
<b>Gjeometria në plan</b>	16%	-klasifikon shumëkëndëshat sipas vetive të tyre; - vizaton këndet e ngushta dhe këndet e gjera; - llogarit dhe kontrollon shumën e këndeve të një trekëndëshi.	U 10	U 8 U 12	U 9
<b>Gjeometria ne hapsire</b>	10%	-përshkruan trupat gjeometrikë sipas vetive të tyre; - përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet).		U 11	
<b>Gjithsej</b>	100 %		14=38 %	14% =38%	9 = 24%

Pikët	0-8	9 - 13	14 - 18	19 -23	24 -28	29 - 33	34 -37
Nota	4	5	6	7	8	9	10

- Cilët numra të plotë mund të vendosim në vend të shkronjës X që të jetë i vërtetë mosbarazimi. (Përdor boshtin)  $-2 < x < 2$  1 pikë
- Gjeni leximin e termometrit nëse: 2 pikë
  - termometri tregon :  $4^{\circ}\text{C}$  më ftohtë se  $-2^{\circ}\text{C}$  .....(Përdor boshtin)
  - termometri tregon :  $4^{\circ}\text{C}$  më ngrohtë se  $-5^{\circ}\text{C}$
- Lidh me shigjetë veprimet në shtyllën e parë me rezultatet në shtyllën e dytë 5 pikë

$554,3 - 433,27 =$	-60
$1023,78 + 6015,24 =$	-2
$-43 + (-17) =$	9
$-4 - (-13) =$	7039.02
$19 + (- 21) =$	121.03

- Përdor metodën më të thjeshtë për të kryer veprimin. 4 pikë

Veprimi	Arsyetimi
a) $4,3+2,9=$	
b) $320 \cdot 5 =$	
c) $6743 - 2997 =$	
d) $125 \cdot 1001 =$	

- Herësi i pjesëtimit  $9135 : 63$  është 1 pikë
  - 136
  - 140
  - 145
  - 153
- Dallo cili nga herësat e mëposhtëm është numër i plotë , cili i përafërt. Në herësat e përafërt, dallo ata që shkruhen si numër dhjetor i fundëm dhe ato që shkruhen si nr. i përzier. 3 pikë  
 $2145:4$                        $2145: 3$                        $2145:7$

Herës i saktë	Herës i përafërt	
	Herës që shkruhet si numër dhjetor i fundem	Herës që shkruhet si numër i përzier

7. Nisur nga barazimi  $32 \cdot 20 = 640$ , plotëso pa kryer veprimin.

$$0.32 \cdot 20 = \underline{\quad\quad} \quad 32 \cdot 0.2 = \underline{\quad\quad} \quad 3.2 \cdot 20 = \underline{\quad\quad}$$

3 pikë

8. Diagonalet e një katërkëndëshi janë të barabarta, kur ai është:

1 pikë


- A) Romb
- B) Drejtëkëndësh
- C) Paralelogram
- D) Balonë

9. Zbulo çfarë është figura e vizatuar me sa më pak matje.

Trego vetinë që përdore \_\_\_\_\_

Emërto figurën dhe plotëso

- a. -Brinjët janë :  $\underline{\quad} \quad \underline{\quad} \quad \underline{\quad} \quad \underline{\quad}$
- b. -Këndet janë:
- c. -Diagonalet janë: .....
- d. -Perimetri i tij është:  $P = \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad}$



8 pikë

10. Qarko cila nga treshet e këndeve të mëposhtme janë kënde të një trekëndëshi.

1 pikë

- A)  $120^\circ, 15^\circ, 55^\circ$
- B)  $12^\circ, 35^\circ, 163^\circ$
- C)  $27^\circ, 48^\circ, 105^\circ$
- D)  $25^\circ, 48^\circ, 105^\circ$

Argumetoni pse përgjigja juaj është e saktë \_\_\_\_\_

1 pikë

11. Cili është trupi : 4 pikë

ELEMENTET

TRUPI GJEOMETRIK:

Baza

Faqe të tjera




.....



Për trupin e gjetur plotësoni:

numri brinjëve.....; numri kulmeve.....; numri faqeve..... ;

12. Gjej këndet në figurë nëse trekëndëshi është dybrinjënjëshëm ( $AC=CB$ ) dhe këndi C është  $110^\circ$  3 pikë



**Klasa VI Test 1, koha 45 min, mësuese Irena Tafani, shkolla “Naim Frashëri”, Elbasan**

Pikët	0 - 9	10-15	16 - 20	21 - 25	26 -30	31 - 35	36 - 40
Nota	4	5	6	7	8	9	10
Niveli	1	2		3		4	

1. ✍ Plotësoni fjalitë: 3 pikë
- Shuma e dy numrave negativë, është gjithmonë numër \_\_\_\_\_.
  - Kubi është një \_\_\_\_\_ me brinjë të barabarta.
  - Piramida 4-këndore ka \_\_\_\_\_ brinjë, \_\_\_\_\_ kulme dhe \_\_\_\_\_ faqe.
2. ✍ Shkruani:
- Numrin e plotë më të madh negativ me tre shifra të ndryshme. 1 pikë
  - Numrin e plotë më të vogël pozitiv dyshifror me shifra të ndryshme. 1 pikë
  - Gjeni shumën dhe ndryshesën e tyre. 2 pikë
3. ✍ Pika me koordinata  $(-3;3)$  ndodhet në kuadratin: 1 pikë
- I
  - II
  - III
  - IV
4. ✍ Drejtkëndëshi ka: 1 pikë

- A) 1 bosht simetrie
- B) 2 boshte simetrie
- C) 4 boshte simetrie
- D) S'ka bosht simetrie

5. Lidhni me shigjetë:

3 pikë

$6.2 \cdot 0.7$	4,34
$12.3 \div 3$	1,62
$0.43 + 1.19$	4,1

6. Një nëndetëse ndodhet në thellësinë 400 m. Ajo zhytet edhe 200 m më thellë. Më pas ngjitet 250 m dhe rizhytet përsëri më 120 m. Në cilën thellësi nga niveli i detit ndodhet nëndetësja?

2 pikë

7. Në orën 22:00, temperatura ishte  $-2^{\circ}\text{C}$ . Pas 2 orësh u ul me  $3^{\circ}\text{C}$ . Sa është temperatura në orën 24:00?

1 pikë

8. Tabela e mëposhtme jep çmimet e disa artikujve elektrikë në euro.

Artikulli	Hekur për hekurosje	Shtrydhëse frutash	Ngrohëse	Mikrovalë	Tostier
Çmimi	56,6€	100€	15,4€	50,50€	40,42€

a) Nëse Miri blen 1 shtrydhëse frutash, 1 ngrohëse dhe 1 mikrovalë, sa euro shpenzon?

1 pikë

b) Çmimi i ngrohëses, i hekurit dhe i tostierit përgjysmohet. Sa euro më pak do paguaj Ana nëse blen 1 ngrohëse, 1 hekur dhe 1 tostier?

2 pikë

c) Çmimi i shtrydhëses së frutave ulet me 22€. Sa % u ul çmimi?


1 pikë

d) Nëse me çmimet e tabelës, bleni 1 hekur, 1 shtrydhëse frutash, 2 ngrohëse 1 mikrovalë dhe 2 tastiera, ju mjaftojnë 400 euro?

2 pikë

9. Gjeni masën e këndeve në figurë me sa më pak matje.

5 pikë



10. Gjeni drejtëzat e simetrisë së figurave të dhëna:

4 pikë




11. Tregoni 3 veti të paralelogramit

3 pikë

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

12. Emërtoni secilin nga trupat gjeometrikë. Përkruani trupin C.


3 pikë



13. Në rrjetin koordinativ gjeni vendodhjen e pikave me koordinata :

$A(2, 1)$ ;  $B(4, 4)$ ;  $C(2, 5)$  dhe  $D(0, 4)$ .

- a) Zhvendosni katërkëndëshin e formuar me dy njësi djathtas dhe tre njësi poshtë. 3 pikë
- b) Ndërtoni simetrikën e katërkëndëshit ABCD sipas boshtit Oy. Gjeni koordinatat e katërkëndëshit të ri. 3 pikë



<b>Pikët</b>	0-7	8-12	13-17	18-22	23-27	28-32	33-35
<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10
<b>Niveli</b>	1	2		3		4	

1. Plotësoni me njësinë e përshtatshme: 5 pikë
  - a) Lartësia e malit Tomorr matet në .....
  - b) Gjatësia e një milingone matet në .....
  - c) Gjatësia e klasës matet në ....
  - d) Masa e një gote matet ....
  - e) Vëllimi i njw pishine ....
  
2. ✎Plotësoni deri tek numri 10 m vargun: 2 pikë  
8,60 m; 8,80 m; ..... ; ..... ; .....; .....
  
3. ✎Kthe në njësinë më të vogël: 3 pikë
  - a) 3 km 67 m = ... m + ... m = ... m;
  - b) 1g 79 mg = ... mg + ....mg = ... mg;
  - c) 9 min 20 sek = ... sek + ... sek = ... sek;
  
4. ✎Nga dy stacione të linjës urbane, u nisën njëkohësisht drejt njëri-tjetrit dy autobusa. Largësia midis stacioneve është 1 km. Njëri nga autobusët përshkoi 140 m, kurse autobusi tjetër 160 m. Sa është tani largësia midis tyre? 2 pikë
  
5. ✎Një udhëtar mund të marrë në avion një peshë deri në 40 kg. Ai mban një çantë udhëtimi me masë 12 kg dhe një valixhe 2 herë më të rëndë. A ka probleme ai për transportin e tyre me avion? 2 pikë
  
6. ✎Për të peshuar një libër, Genci ka vënë në pjatën tjetër të peshores këto masa: 200 g; 50 g; 10 g; 1 kg. Sa është masa e librit? 2 pikë
  
7. ✎Një eklips total i diellit mbaroi në orën 14:01. Eklipsi zgjati 3 min. Në ç'farë ore filloi ai? 1 pikë
  
8. ✎Në ShBA, sahatët tregojnë 6 orë më pak se në Tiranë, kurse në Pekin 6 orë më shumë se në Tiranë.
  - a) Nëse në Tiranë ora tregon 12:30, sa tregon ora në Amerikë? Po në Pekin? 2 pikë
  - b) Sa është diferenca e orëve ndërmjet Pekinit dhe Amerikës? 2 pikë

c) Ju filloni mësimin në orën 8:00. Çfarë mund të jenë duke bërë moshatarët tuaj në Amerikë dhe në Pekin? 2 pikë

d) Në cilat orare ju mund të komunikoni me moshatarët tuaj në Amerikë? Po në Pekin? 2 pikë



9. Pushimi i madh filloi në orën 10 : 35 dhe mbaroi në orën 11 : 05 . Sa minuta zgjati ai? 2 pikë

10. Një lugë kafeje nxë 5 ml lëng. Për t'i dhënë një fëmije përmbajtjen e një kanaçeje të vogël komposto prej 10 cl, sa lugë kafeje me komposto duhet t'i japim? 2 pikë



11. Sa shishe vere 0,7 l duhen për të ambalazhuar 3,5 hektolitra verë? 2 pikë

12. Shkruani kohën fillestare në orën digjitale dhe më pas llogaritni kohën përfundimtare në orën me akrepa:

a) Njëmbëdhjetë e tetëmbëdhjetë minuta e darkës, 4 orë e 18 minuta më vonë. 2 pikë



b) nëntë e tridhjetë minuta e mëngjezit, 7 orë e 22 minuta më vonë. 2 pikë



## Klasa VI

Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Ogerta Kapa, shkolla “4 Dëshmorët”, Tiranë

Konceptet	Përqindja (Pikët)	Rezultatet e të nxënit	N <sub>2</sub> niveli i arritjes së kompetencave	N <sub>3</sub> Niveli i arritjes së kompetencave	N <sub>4</sub> Niveli i arritjes së kompetencave
<b>Numri</b>	42% =12 pikë	kryen veprime me numrat dhjetorë; kryen veprime me numra me shenjë duke analizuar rezultatin.	Ushtrimi 1 Ushtrimi 2 (a) Ushtrimi 4		Ushtrimi 2 (b)
<b>Shumëzimi i numrave dy, tre dhe katërshifrorë</b>	10%=3 pikë	kryen shumëzimin në shtyllë; shumëzon duke ndarë numrin.		Ushtrimi 3 (a) Ushtrimi 3 (b)	

<b>Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave dhjetorë</b>	18%=5 pikë	analizon gjetjen e kostos së një produkti.		Ushtrimi 8 (a+b+d)	Ushtrimi 8 (c)
<b>Trupat 3-D</b>	8%=2 pikë	tregon të përbashktat midis cilindrit dhe kubit.		Ushtrimi 5	
<b>Figurat 2-D</b>	22%=6 pikë	gjen masat e këndeve të një trekëndëshi dhe e vizaton atë; analizon gjetjen e perimetrit të drejtkëndëshit.		Ushtrimi 6	Ushtrimi 7
<b>Pikët</b>	100%=28 pikë		10 pikë (36%)	11 pikë (39%)	7 pikë (25%)

<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10
<b>Pikët</b>	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-26	27-28

1. Çifto elementet e kolonës A me elementet e kolonës B:

(4-pikë)

<b>A</b>	<b>B</b>
576-259	693,6
726,4-32,8	17,16
47,5+13,6	317
3,3 · 5,2	61,1
	611

2. Kryej veprimet:

(2+2=4 pikë)

a)  $-4+(-7) =$   $-4 \cdot (-4) =$

$-4+(-8) =$   $-3:(-3) =$

$-5+(-3) =$   $-5 \cdot 2 =$

b)  $\{2+4 \cdot [-4+(2-6):(-2)]+3\} =$

3. Shumëzoni me dy mënyra:  $3144 \cdot 32$

(1 + 2 = 3 pikë)

a) Në shtyllë

b) Me copëzim

4. Kryej veprimet:

(4 pikë)

$2,3 \cdot 3,4 =$   $2,5 \cdot 4 =$   $1,6 : 0,2 =$   $2,6 : 0,4 =$

5. Trego vetitë e përbashka ndërmjet kubit dhe cilindrit. **(2 pikë)**
6. Këndet e një trekëndëshi janë në raportin 1:2:3. Gjeni këndet dhe vizatoni trekëndëshin. **(3 pikë)**
7. Një kopsht në formë drejtkëndëshi e ka një brinjë 2 cm më të vogël se brinja tjetër. Për ta rrethuar të gjithë kopshtin duhet 30 m tel. Gjeni gjatësinë dhe gjerësinë e kopshtit. **(3 pikë)**
8. Ana do të përgatisë një lëng frutash me këta përbërës: 0.5 kg portokall, 0.25 kg mollë dhe 400 gr banane. Një kilogram banane kushton 1.6 Euro, një kilogram portokall kushton 2.2 Euro dhe një kilogram mollë kushton 1.2 Euro.
- Sa ishte kostoja e portokallit që përdori Ana?
  - Sa ishte kostoja e mollës që përdori Ana?
  - Sa ishte kostoja e bananes që përdori Ana?
  - Sa ishte kostoja e lëngut që përgatiti Ana?
- (1+1+2+1=5-pikë)**

**Klasa VI Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Lorena Pazaj, Vlorë**

1. Lidh me shigjetë: 3 pikë

Shuma e dyfishit të një numri me 7 është 15.
Diferenca e 30 me trefishin e një numri është 9.
Një numër është i barabartë me gjysmën e diferencës së 21 me 7.

$30 - 3x = 9$
$x = \frac{21 - 7}{2}$
$2x + 7 = 15$
$2x + 7 = 15$


2. Qarko e vërtetë ose e gabuar: 3 pikë
- Shuma e këndeve të një trekëndëshi është  $180^\circ$ . V G
  - Këndi i gjerë e ka masën më të madhe se  $90^\circ$ . V G
  - Këndi i plotë e ka masën  $270^\circ$ . V G
3. Plotësoni vendet bosh: 3 pikë
- Numra të thjeshtë quajmë çdo numër që \_\_\_\_\_.
  - Numri 24 ka faktorë \_\_\_\_\_.
  - Numrat që nuk janë të thjeshtë quhen \_\_\_\_\_.
4. Plotëso katrorin magjik 4 pikë

5		3
	-1	

		2
--	--	---

5. Alba po lexon një libër. Ditën e dytë lexoi sa dyfishi i faqeve të ditës së parë dhe ditën e tretë sa dyfishi i faqeve të ditës së dytë. Sa faqe lexoi Alba çdo ditë, në qoftë se libri kishte 300 faqe dhe Albës i mbetën edhe 20 faqe për të lexuar? 5 pikë
6. Në qoftë se një krimb çdo ditë ngjit 3 metra dhe zbret 2 metra në një pemë 15 metra të lartë, për sa ditë e ngjit krimbi pemën? 3 pikë

7. Plotëso: 3 pikë



8. Ndërto figurën me koordinata : A(3,2), B(5,3) dhe C(4,7) në rrjetin koordinativ. Ndërto simetrikën e figurës në lidhje me boshtin e abshisave dhe gjej koordinatat e reja të figurës së formuar. 3 pikë

9. Ana po luan me një zar kubik.

- a) Sa është probabiliteti që të bierë numri 6? 1 pikë
- b) Sa është probabiliteti që të bierë një numër më i vogël se 4? 2 pikë

10. Andi po studion në një lagje të qytetit moshën mesatare të fëmijëve. Ai mori në shqyrtim dhjetë familje dhe rregjistroi moshën e fëmijëve të tyre. Të dhënat janë si më poshtë:

7, 13, 19, 2, 5, 3, 10, 7, 3, 5, 21, 24, 1, 11, 13, 19, 5, 2, 5, 2.

- a) Ndërtoni tabelën e dendurive. 1 pikë
- b) Gjej modën.
- c) Gjej mesoren. 1 pikë
- d) Gjej moshën mesatare të fëmijëve. 2 pikë

**Klasa VII Test përmbledhës, koha 45 min, mësues Gentjan Canaj, shkolla “Hasan Mëhilli”, Vlorë**

1. Gjatësia e 3 paneleve të një gardhi është 5.4 m. Gjeni sa është gjatësia e 10 paneleve të gardhit. 2 pikë
2. Ndani 15 euro midis Tanit dhe Andit në raportin 1:2. 2 pikë
3. Në tabelë janë dhënë oraret e autobusit urban të qytetit.



- a. Në çfarë ore arrin autobusi i orës 13:29 në kështjellë? 1 pikë
- b. Anila arrin në stacion, por i iku autobusi i orës 13.54. Sa duhet të presë për autobusin tjetër? 1 pikë
- c. Në cilën orë do të arrijë të marrë autobusin nga kështjella për tek Ura e Re? 2 pikë

	Orari i nisjes	Orari i nisjes	Orari i nisjes	Orari i nisjes
<b>Stacioni</b>	13.29	13.54	14.19	14.44
<b>Kështjella</b>	13.46	14.11	14.36	15.01
<b>Fusha e futbollit</b>	14.08	14.33	14.58	15.23
<b>Ura e Re</b>	14.22	14.47	15.12	15.37

4. Mira vendosi në tavolinë 10 letra me numrat nga 1 deri në 10. Ajo zgjodhi rastësisht një letër. Sa është probabiliteti që letra e zgjedhur të ketë:

- a. Numrin 7; 1 pikë
- b. Numër më të vogël se 4; 1 pikë
- c. Numër tek; 1 pikë
- d. Numër, shumëfish të 3-shit; 1 pikë
- e. Numër të ndryshëm nga 10 1 pikë


5. Beni hodhi 2 zare njëkohësisht dhe mblodhi pikët e rëna. Tabela më poshtë jep ngjarjet e përfuara nga hedhja e zareve 80 herë.

Gjithsej	Më pak se 5 pikë	Nga 5 deri në 10 pikë	Më shumë se 10 pikë
Denduria	16	56	8

- a) Gjeni probabilitetin statistikor që shuma e pikëve të rëna të jetë:

- i. Më pak se 5 pikë; 1 pikë
- ii. Më shumë se 10 pikë 1 pikë
- iii. 5 pikë ose më shumë 1 pikë

6. Dioni vizatoi një figurë në rrjetin koordinativ si më poshtë. Zhvendose figurën 4 njësi majtas dhe 2 njësi lart. Më pas zhvendose edhe 2 njësi djathtas dhe 5 njësi poshtë. Cilat janë koordinatat e reja të figurës? 3 pikë



7. Mësuese Violeta zhvilloi një testim në matematikë. Më poshtë paraqiten pikët që morën nxënësit. Testimi vlerësohej me 20 pikë gjithësej. 4 pikë
- 16; 17; 9; 19; 12; 3; 12; 1; 20; 7; 10; 11; 18; 2; 8; 12; 3; 16; 6; 7; 19; 15; 15; 18; 9; 12; 8; 17;

a) Plotësoni tabelën me denduritë e grumbulluara.

Pikët	Denduria
1-5	
6-10	
11-15	
16-20	

8. Mira bëri test në 3 lëndë. Rezultatet e saj janë:

38 pikë nga 50 pikë të mundshme në matematikë

28 pikë nga 40 pikë në histori

16 Pikë nga 20 pikëpyetje në gjeografi

a) Cila është përqindja e pikëve që ajo ka marë në secilën lëndë? 3 pikë

b) Në cilën prej lëndëve Mira ka dalë më mirë? Argumentoni. 2 pikë

9. Ndërtoni grafikun e funksionit  $y = 2x + 1$ . 3 pikë

10. Në një stadium janë 24310 sportdashës. Raporti ndërmjet meshkujve dhe femrave është 10:1.

Gjeni sa meshkuj janë në këtë stadium. Argumentoni përgjigjen tuaj 3 pikë

### Klasa VIII Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Angjelina Gjergji, Lezhë

1. Zgjidhni alternativën e duhur. V kur barazimi është i vërtetë dhe G kur është i gabuar. 4 pikë

A)  $(-4) + (-14) = 18$

V	G
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

B)  $(-15) - 12 = 3$

C)  $9 \cdot (-7) = -63$

D)  $(-125) \div 5 = 25$

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2. Vlera e shprehjes  $7 - 3x$  për  $x = 2$  është e barabartë me 1. 2 pikë

Argumentoni përgjigjen dhe gjeni vlerën e kësaj shprehjeje për  $x = -2$ .

3. Katër fëmijë e përshkruajnë kështu një figurë gjeometrike:

Joni thotë: “Figura është një katërkëndësh”.

Ana thotë: “Figura ka vetëm një drejtëz simetrie”.

Teuta thotë: “Ka një çift brinjësh të barabarta”.

Era thotë: “Ka diagonale të barabarta”.

Për cilin katërkëndësh bëhet fjalë? 2 pikë

4. Era zgjidhi ushtrimin e mëposhtëm. Gjeni gabimin që ka bërë ajo. 1 pikë

$$11 \div 2 \frac{1}{5} - 2 \cdot \frac{3}{8} = 11 \cdot \frac{2}{5} - \frac{6}{8} = \frac{13}{40}$$


5. Cila nga thyesat e mëposhtme është më e madhe? 3 pikë

A)  $\frac{9}{10}$  .....  $\frac{8}{9}$


B)  $\frac{3}{7}$  .....  $\frac{6}{13}$

C)  $\frac{3}{5}$  .....  $\frac{5}{9}$

6. Lidh me shigjetë elementët e A që jqnë barabartë të me elementët e B. 2 pikë




7. Shkruani shprehjen që jep syprinën e pjesës së ngjyrosur. Thjeshtojeni atë. 3 pikë



8. Plotësoni vendet bosh sipas figurës:

3 pikë

c dhe \_\_\_\_\_ janë kënde përgjegjëse  
 e dhe \_\_\_\_\_ janë kënde të kundërt në kulm  
 d dhe \_\_\_\_\_ janë kënde ndërruese të brendshme.



9. Në një fermë, sasia prej 270 litrash qumësht ndahet në këtë mënyrë.

2 pikë

180 litra futen në bidonë që nxënë nga  $4\frac{1}{2}$  litra, kurse pjesa tjetër që mbetet, futet në bidonë që nxënë nga  $3\frac{1}{2}$  litra qumësht. Sa bidonë mbushen gjithsej ?

10. Zëvendësoni ? me një numër, në mënyrë që të marrim barazime të vërteta

2 pikë


$$0,5 \cdot 0,1 = ? \quad ? \div 0,01 = 12$$

11. Klara, Ana dhe Frida luajnë herë pas here shah në shtëpi me shokët e klasës. Klara luan me interval pushimi 2 ditë ndërmjet ndeshjeve; Ana me interval 3 ditë ndërmjet ndeshjeve dhe Frida me interval 5 ditë ndërmjet ndeshjeve. Ato luajtën të tria në datën 1 Mars. Në cilën datë do të luajnë ato përsëri të tria njëkohësisht?

1 pikë

12. Gjeni masat e këndeve A, B dhe C të trekëndëshit ABC.

3 pikë



13. Ana dhe Teuta mbushin dy enë që nxënë përkatësisht nga 5,4 litra dhe 4,2 litra. Ana përdor një gotë që nxë 0,4 litra, kurse Teuta një gotë që nxë 0,3 litra. Cila nga të dyja hedh më shumë gota në enë? Shpjegoni përgjigjen.



2 pikë

<b>Pikët</b>	0 - 7	8 - 12	13 - 17	18 - 21	22 - 25	26 - 29	30 - 32
<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10

**Klasa VIII Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Anila Simoni, shkolla “Drita Pelingu”,  
Tiranë**

1. Lidh me shigjetë monomet e ngjashme.

3 pikë

A	B
	

2. Shprehja identike me shprehjen  $(x-2) \cdot 4$  është:

1 pikë

- A)  $4x - 2$
- B)  $4x - 8$
- C)  $x - 8$
- D)  $8 - 4x$

3. Vlera e shprehjes  $-24 : (7 - 4)$  është:

1 pikë

- A)  $-8$
- B)  $-6$
- C)  $4$
- D)  $8$

4.  $(-3)^3$  është e barabartë me:

1 pikë

- A)  $-27$
- B)  $-9$
- C)  $9$
- D)  $27$

5. Kryej veprimet.

4 pikë

a)  $(-2)^3 \div (-4 + 6) \cdot \sqrt{25} =$

b)  $\sqrt[3]{27} - \sqrt{16} =$

6. Një lloj gjinkalle shfaqet çdo 17 vjet, ndërsa një lloj tjetër shfaqet çdo 13 vjet. Plotësoni fjalinë vijuese duke përdorur fjalën “SH.V.P” ose “P.M.P”.

a) Skenari i gjinkallës është një shembull nga natyra ku përdoret \_\_\_\_ . 1 pikë

b) Gjinkallat u shfaqën njëkohësisht në vitin 2016. Në cilin vit do të shfaqen ato sërish njëkohësisht? 2 pikë

c) Supozojmë se ciklet jetësore të gjinkallës janë 18 vjet dhe 12 vjet. Pas sa vitesh do të shfaqen ato prapë njëkohësisht? 1 pikë

7. Vendos kllapat në mënyrë që rezultati të jetë i saktë. 2 pikë

$$9 - 2 \cdot 3 - 1 = 20$$


8. Vendos në rendin zbritës. 3 pikë

$$-\sqrt{16} ; 2^3 ; (-2)^4 ; \sqrt{144} ; \sqrt[3]{1000}$$

9. Kthe në formë të rregullt, pastaj gjej vlerën e shprehjes për  $x = -2$


$$3(1 - 3x) + 2(x + 2) = \quad 4 \text{ pikë}$$

10. Drejtëza d dhe d<sub>1</sub> janë paralele. Gjej masën e këndeve x dhe y. 3 pikë



11. Treni i parë niset çdo 24 min , treni i dytë niset çdo 36 min. Pa sa minutash nisen të dy trenat njëkohësisht. 2 pikë

12. Shkruaj një shprehje për syprinën e pjesës së ngjyrosur. Thjeshto shprehjen. 4 pikë



**Klasa VIII**  
**45 min,**  
**Vlorë**

**Test përmbledhës, koha**  
**mësuese Arta Mezuri,**

<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10
<b>Pikët</b>	0-8	9-12	13-16	17-21	22-25	26-29	30-33

1. Gjeni vlerën e shprehjeve. (2/ \_\_ pikë)

a.  $(8 + 15 - 29) : (-7 + 9) =$

b.  $\sqrt[3]{27} + \sqrt{64} - \sqrt[3]{-8} + (-2)^3 + 5^2 =$

2. Gjeni Sh.V.P. dhe P.M.P. e numrave (2/ \_\_ pikë)

a. 30 dhe 45;

3. Shkruani me simbole matematike: (2/ \_\_ pikë)

Gjysma e shumës së 4-ës me dyfishin e një numri. \_\_\_\_\_

4. Kryej veprimet me monome. (3/ \_\_ pikë)

a.  $6x \cdot (5xy) =$  \_\_\_\_\_

b.  $xyz \cdot (-4xy^2) =$  \_\_\_\_\_


c.  $(2xy)^2 =$  \_\_\_\_\_

5. Sillni shprehjet në trajtë të rregullt dhe gjeni vlerën numerike të shprehjes për  $x = -2$  dhe  $y = 3$ .

$4(x + 2y) - 3(-x - 4y) =$  (2/ \_\_ pikë)

6. Gjeni masat e këndeve që mungojnë në figurat e mëposhtme duke gjetur si fillim  $x$ .

(3/ \_\_ pikë)



7. Vizatoni hapjen e prizmit trekëndor me bazë trekëndëshin barabrinjës me brinjë 2 cm dhe brinjë anësore 3 cm. (3/ \_\_ pikë)

8. Njëra diagonale e rombit formon me brinjën këndin  $40^\circ$ . Gjeni këndet e rombit (2/\_\_\_pikë)
9. Thjeshto thyesat dhe krahasoju ato.  $\frac{28}{42}$  ;  $\frac{40}{58}$  (2/\_\_\_pikë)
10. Kryej veprimet: a)  $2\frac{3}{4} + 1\frac{2}{5} =$  b)  $4,12 + 122,7 =$  (5/\_\_\_pikë)
- c)  $0,5 \cdot 9 =$  d)  $63,5 : 5 =$  e)  $23,4 : 0,001 =$
11. Një bojaxhiu i duhen 30 litra bojë për të lyer. Ai bleu 7 kuti që nxinin secila 4.3 litra. A i mjafton kjo bojë bojaxhiut ? (3/\_\_\_pikë)
12. Në tabelën me dy hyrje jepet informacioni për shtëpitë në shitje të një qyteti. (4/\_\_\_pikë)

Lloji i shtëpive	Numri i dhomave				
	Me 1 dhomë	Me 2 dhoma	Me 3 dhoma	Me 4 dhoma	Me 5 dhoma
Private	0	8	23	14	6
Apartament	0	5	41	6	2
Gjysmëprivate	1	7	15	3	0

- a) Sa shtëpi private kanë nga 4 dhoma gjumi?
- b) Zgjedhim rastësisht një shtëpi. Ajo ka 3 dhoma. Çfarë mundësie më shumë ka ajo që të jetë?
- c) Sa shtëpi kanë 2 ose më shumë dhoma?
- d) Shtoni një rresht dhe një shtyllë për të gjetur sa janë gjithsej.

**Klasa VIII Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Servete Mecaj, shkolla “Betim Muço”, Tiranë**

Konceptet	Përqindja =Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së Komp.	Niveli III i arritjes së Komp.	Niveli IV i arritjes së komp.
<b>Gjatësia, masa dhe vëllimi</b>	17%=5 pikë	➤ zgjedh njësitë e përshtatshme të gjatësisë e të masës për madhësitë e dhëna.	U1		



<b>Ekuacionet</b>	23%=7 <b>pikë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ përcakton rrënjën e një ekuacioni të dhënë;</li> <li>➤ gjen zgjidhjen e një ekuacioni të dhënë;</li> <li>➤ ndërton dhe zgjidh ekuacione që kanë koeficientë numra të plotë.</li> </ul>	U2	U3a,c U4b	U3b U4a
<b>Figurat Gjeometrike dhe arsyetime</b>	37%=11 <b>pikë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ përcakton vetinë e mesoreve dhe përgjysmoreve të një trekëndëshi;</li> <li>➤ përcakton vetitë e trekëndëshit kur njih llojin e tij;</li> <li>➤ zbaton vetinë e shumës së këndeve të trekëndëshit për të gjetur këndet e tij;</li> <li>➤ njehson këndet e trekëndëshit duke ditur njërin kënd dhe llojin e tij.</li> </ul>	U5  U6	U7a,d,e	U7b,c
<b>Paraqitja e të dhënave</b>	23%=7 <b>pikë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ analizon dhe interpreton rezultatet nga një diagram i dhënë;</li> <li>➤ paraqet të dhënat në tabelën e dënuarive në një situatë konkrete nga jeta reale.</li> </ul>		U8a,b U8c,d,e	U8f
<b>Pikët totale të testit</b>	<b>30 pikë</b>		<b>40%=12 pikë</b>	<b>40%=12 pikë</b>	<b>20%=6 pikë</b>

### Tabela e pikëve

<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10
<b>Pikët</b>	< 7	7-10	11-14	15-18	19-22	23-26	27-30

1. Lidhni madhësitë me njësitë përkatëse matëse:

5 pikë

Masa e një karrigeje	g
Largësia midis dy qyteteve	ml
Masa e ujit në vaskë	km
Lartësia e një shtëpie	Kg
Masa e një lapsi	cm

2. Qarko alternativën e saktë. Rrënja e ekuacionit  $7x - 2 = 19$  është numri: 1 pikë
- A) 5  
B) 7  
C) 3  
D) -2
3. Vlera numerike e shprehjes A është 12 më e madhe se ajo e shprehjes B. 3 pikë
- A.  $5x + 4$                       B.  $3x - 4$
- a) Shkruaj barazimin që lidh këto dy shprehje.  
b) Zgjidh ekuacionin e formuar.  
c) Argumento veprimet e kryera.
4. Erika mendoi një numër. Ajo e shumëzoi me 7 dhe i zbriti 5. Rezultati doli 51. 3 pikë
- a) Shkruani ekuacionin që paraqet fjalë e mësipërme  
b) Cili është numri që mendoi Erika?  
Ajo mendoi numrin \_\_\_\_\_.
5. Plotësoni fjalitë e mëposhtme: 2 pikë
- a) Mesoret e trekëndëshit priten \_\_\_\_\_  
b) Pikëprerja e përgjysmoreve të trekëndëshit ndodhet \_\_\_\_\_ të trekëndëshit.
6. Për pohimet e mëposhtme rretho e vërtetë e gabuar V; G 4 pikë
- Trekëndëshi barabrinjës:
- a) Mund të jetë këndgjerë V;G  
b) Mund të jetë kënddrejtë V;G  
c) Është gjithmonë këndngushtë V;G  
d) Lartësitë priten gjithmonë në një pikë të brendshme V;G
7. Plotësoni tabelën: 5 pikë

Masat e këndeve			Lloji i trekëndëshit
<A	<B	<C	
	30°		Kënddrejtë
40°			Këndngushtë, dybrinjëshëm
		70°	Këndgjerë
	25°		Kënddrejtë

	45°		Kënddrejtë dybrinjëshëm
--	-----	--	-------------------------

8. Një mësuese zhvilloi një anketim me 20 nxënës për llojin e preferuar të filmave që ata pëlqejnë të shohin në kinema. Diagrami rrethor tregon të dhënat e këtij studimi. Gjeni:

- Sa nxënës pëlqejnë filmin aksion?
- Sa nxënës pëlqejnë filmin komedi?
- Sa nxënës pëlqejnë filmin romancë?
- Sa nxënës pëlqejnë filmin dramë?
- Sa % e nxënësve pëlqejnë filmat romancë dhe aksion?
- Ndërtoni një tabelë dendurish për këtë anketim.



7 pikë

**Klasa IX Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Anila Simoni, shkolla "Drita Pelingu", Tiranë**

Pikët	0 - 8	9 - 12	13 - 16	17 - 20	21 - 24	25 - 28	29 - 32
Nota	4	5	6	7	8	9	10

1. Ekuacioni  $\frac{x-a}{2} = -1$  ka rrënjë  $x = 1$ , atëherë vlera e  $a$ -së është :

1 pikë

- 2
- 3
- 4
- 5

2. Që ekuacioni  $(m-1) \cdot x = 2$  të mos ketë zgjidhje vlera e  $m$  duhet të jetë:

1 pikë

- 1
- 0
- 1
- 2

3. Zgjidhja e sistemit  $\begin{cases} x - y = 3 \\ x + y = 5 \end{cases}$  është çifti:

1 pikë

- (2 ; 1)

B) (4 ; 1)

C) (3 ; 0)

D) (-2 ; 1)

4. Kryeni veprimet: 3 pikë

a)  $3.5 + 2.7 - 1.2 \cdot 2.5 =$

b)  $2 \cdot (-3) + 12 - 35 \div (-5) =$

5. Zgjidh ekuacionet dhe inekuacionet : 8 pikë

a)  $4(2 - 3x) - 2(x - 2) = 6 - 4x$

b)  $1 - \frac{2x-5}{6} = \frac{3-x}{4}$

c)  $5x - 2(3x - 4) < 4$

d)  $\frac{x-1}{4} - 3 \leq \frac{2x-1}{3} + x$

6. Zgjidh sistemin me një nga mënyrat që njeh:  $\begin{cases} 3y = x + 10 \\ 13x + 2y = -7 \end{cases}$  4 pikë

7. Një parcelë është në formën e një trekëndëshi dybrinjënjëshëm me bazë 16 m dhe me brinjë anësore 10 m. Gjej syprinën e parcelës. 3 pikë

8. Dy nxënës kanë sëbashku 15 lekë. Nëse njëri i jep tjetrit 4 lekë atëherë atij i mbetën 2 herë më pak lekë sesa i bëhen tjetrit. Sa lekë ka secili nxënës? 4 pikë

9. Jepet një 15- këndësh i rregullt. Gjeni: 3 pikë

a) këndin e brendshëm

b) këndin e jashtëm

10. Në trapezin kënddrejtë ABCD (AB//CD) kemi  $m(\hat{A}) = 45^\circ$ , AB = 26 cm, CD = 20 cm.

Gjeni syprinën e trapezit. 4 pikë

### Klasa IX Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Arta Mezuri, Vlorë

Koncepti	%	R N	N2	N3	N4
<b>Grafikët dhe funksioni</b>	9pikë 32%	✓ Ndërton grafikët kur jepet funksioni me formulë. ✓ Përcakton koeficientin këndor. ✓ Gjen funksionin e anasjellë të një funksioni të dhënë. ✓ Zgjidh një sistem me mënyrën grafike.	U1,U2 U3 U9a	U9b U10	
<b>Thyesat ,numrat</b>	6pikë	✓ Thjeshton raporte të dhëna në forma të ndryshme.	U5	U12 U15	

<b>dhjetor dhe %</b>	21%	✓ Gjen % e një numri të dhënë dhe zgjidh problemat me të.			
<b>Statistikë</b>	4pikë 15%	✓ Përcakton elementet statistikore, modë dhe mesore. ✓ Llogarit mesataren aritmetike në një grup të dhënash.		U13a	U13b
<b>Raporti dhe përpjestimi</b>	6pikë 21%	✓ Përcakton raporte të barabarta. ✓ Njehson pjesët e një madhësie të dhënë me raport. ✓ Përdor përpjestimin në zgjidhje problemash.	U4,	U14a	U11 U14b
<b>Koha dhe njësiti e përbëra</b>	3pikë 11%	✓ Evidenton madhësitë e përbëra. ✓ Përcakton njësinë e kohës së nevojshme për zgjidhjen e problemave.	U6,U7 U8		
<b>Totali</b>	28 pikë 100%		11pikë 39%	12pikë 43%	5 pikë 18%

### Shpërndarja e pikëve sipas niveleve të vlerësimit

Niveli	Ushtrimet e përshtatshme	Pikët	Përqindja
<b>Niveli 2</b>	U1 , U2, U4, U5,U6,U7,U8,U9a,U13a	11pikë	39%
<b>Niveli 3</b>	U3 , U9b,U10,U12,U14a,U15	12pikë	43%
<b>Niveli 4</b>	U11 ,U13b,U14b	5pikë	18%

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8 - 12	13 -16	17 -20	21 - 23	24 -26	27 -28

Ushtrimet nga 1 – 8 vlerësohen me 1 pikë.

1- Drejtëza që kalon nga pikat (3 ; 2) dhe (7 ; p) e ka koeficientin këndor 1. Vlera e p-së është:

- A) 2
- B) 8
- C) 10
- D) 6

2- Drejtëza  $5x - 2y = 10$  kalon nga pikat:

- A) (-2 ; 3)

B) (0 ; 5)

C) (4 ; 5)

3- Funkzioni i anasjelltë i funksionit  $y = 5x - 4$  është:

A)  $\frac{4-x}{5}$

B)  $\frac{x+4}{5}$

C)  $\frac{x-5}{4}$

4-  $y$  është në përpjestim të drejtë me  $x$ . Nëse  $y = 21$ ;  $x = 3$  formula që lidh  $y$  me  $x$  është:

A)  $y = 7 + x$

B)  $y + x = 21$

C)  $y = 7x$

5- Raporti 21 : 28 është i barabartë me:

A)  $\frac{3}{4}$

B) 7 : 4

C) 3 + 4

6- 3, 4 orë janë:

A) 3 orë e 40 min

B) 3 orë e 4 min

C) 3 orë e 24 min

7- Shpejtësia e një objekti që bën 180 km në 5 orë është:

A) 60 km/h

B) 36 km/h

C) 180 km për 5 orë

8- Cila nga madhësitë është e përbërë?

A) kg

B) m/s

C) ha

9- Drejtëza kalon nëpër pikat (6; 0) dhe (0; 4). Shkruani ekuacionin e drejtëzës . (3 pikë/\_\_\_)

10- Zgjidhni grafikisht sistemin (3 pikë/\_\_\_)

$$\begin{cases} x + y = 5 \\ x - y = 11 \end{cases}$$

11- Një sustë zgjatet 12 cm nëse i vendosni në fund të saj një trup me masë 7, 2 kg. (2 pikë/\_\_\_)

Zgjatja është në përpjestim të drejtë me masën që varet me të.

a) Gjeni koeficientin e përpjesëtimit.

b) Sa do jetë zgjatimi i sustës nëse në të varim një trup me masë  $m = 4, 5$  kg?

12- Numri i studentëve të një universiteti u rrit me 24%. Tani universiteti ka 527 studentë.

Sa studentë kishte para rritjes së numrit me 24%? (2 pikë/\_\_\_)

13- Në pakot me kopsa shkruhet: Përmban mesatarisht 36 kopsa. Ana i numëroi kopsat

në 100 pako. Të dhënat jepen në tabelën më poshtë: (4 pikë/\_\_\_)

Numri i kopsave	34	35	36	37	38	39	40
Denduria	1	3	44	26	15	9	2

Gjeni modën, mesoren dhe mesataren për numrin e kopsave. A është i saktë shënimi mbi pako?

14- Masat e këndeve të një trekëndëshi qendrojnë si 3:7:10. Gjeni këndet e trekëndëshit dhe shpjegoni

llojin e tij. (3 pikë/\_\_\_)

15- Një bllok plumbi në formë kuboidi është 8 cm i gjatë, 4 cm i gjerë dhe 2,5 cm i lartë. Dendësia e plumbit është  $11,3\text{g/cm}^3$ . Gjeni masën e këtij blloku. Jepni përgjigjen tuaj në kg me afërsi në të dhjetën më të afërt. (3 pikë/\_\_\_)

### Klasa IX Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Enkelejsa Aliaj, Shkodër

*Për pyetjet 1-4 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

1. Largësia e Diellit nga Toka është afërsisht 150 000 000 000 m. Forma standarde e këtij numri është: 1 pikë

A)  $0,15 \times 10^{12}$

B)  $1,5 \times 10^{11}$

C)  $15 \times 10^{10}$

D)  $150 \times 10^9$

2. Vlera e shprehjes  $2a + b^2$  kur  $a = 5$  dhe  $b = 2$  është: 1 pikë

- A) 12
- B) 14
- C) 16
- D) 18

3. Një qytet ka 500 000 banorë. Kryetari i bashkisë do të dijë nëse banorët janë të kënaqur me shërbimet që ofron bashkia. Sa e madhe duhet të jetë zgjedhja për anketimin? 1 pikë

- A) 5
- B) 50
- C) 500
- D) 50 000

4. Vlera e shprehjes  $4\frac{4}{5} - 1\frac{3}{10}$  1 pikë

- A)  $\frac{7}{10}$
- B)  $\frac{7}{5}$
- C)  $\frac{2}{7}$
- D)  $\frac{7}{2}$

5. Shënoni V nqs shprehja është e vërtetë dhe G nqs shprehja është e gabuar: 3 pikë

- a)  $2,3 \in \mathbb{N}$                       V    G
- b)  $-23 \in \mathbb{Z}$                       V    G
- c)  $2,\bar{8} \in \mathbb{Q}$                       V    G

6. Plotësoni fjalinë: 4 pikë

- a) Kënd rrethor quhet këndi që e ka kulmin në \_\_\_\_\_ dhe brinjët \_\_\_\_\_
- b) Për të kthyer kilometrat në milje pjesëtojmë me \_\_\_\_\_ dhe shumëzojmë me \_\_\_\_\_.

7. Bledi shënoi numrin e lëvizjeve që ai kreu për të fituar një lojë shahu.

Numri i lëvizjeve	Denduria
5	1
6	4
7	3
8	3
9	4
10	5



Gjeni:

- a. Amplitudën, modën, mesoren dhe mesataren aritmetike për këto të dhëna. 4 pikë
- b. Përse moda nuk është në këtë rast mesatarja më e mirë për të përshkruar të dhënat? Shpjego përgjigjen tënde. 2 pikë
9. Shkruani, në mënyrat që njihni, bashkësinë e numrave natyrorë dyfishi i të cilëve është më i vogël se 25: 3 pikë
10. Shpjegoni një mënyrë për të gjetur me përafërsi rrënjën katrore të numrit 27: 3 pikë
11. Nxirrni kufizat nga kllapat: 4 pikë
- a)  $6(a + 8) = \dots\dots\dots$
- b)  $4(s - 3) = \dots\dots\dots$
- c)  $4(2a + 8b - 3) = \dots\dots\dots$
- d)  $5(7s - 3 + t) = \dots\dots\dots$
12. Lidhni shprehjen numerike me vlerën numerike përkatëse. 3 pikë

$4 \times (1 + 2)^2$	8
$4 \times 1 + 2^2$	144
$[4 \times (1+2)]^2$	36

13. Shuma e masave të dy këndeve rrethore është 108. Raporti i masave të tyre është 1:3. Sa është raporti i masave të këndeve të tyre qendrore përgjegjëse. 3 pikë
14. Një enë nxë 45 litra ujë. Ajo do të ndahet në shishe që nxënë nga 20 cl secila. Sa shishe do të mbushen? 2 pikë

**Klasa IX Testi 1, koha 45 min, mësuese Irena Tafani, shkolla "Naim Frashëri", Elbasan**

Pikët	0-7	8-11	12-15	16-18	19-22	23-26	27-30
Nota	4	5	6	7	8	9	10

- 1- ✎ Vlera e shprehjes:  $4\frac{1}{5} + 2\frac{3}{4} - 2\frac{1}{2} =$  1 pikë

A)  $4\frac{9}{20}$

B)  $8\frac{19}{20}$

C)  $4\frac{19}{20}$

D)  $4\frac{19}{10}$

2- Shprehja:  $2^5 \cdot 8^{-2} \cdot 4^4$  është e barabartë me: 1 pikë

A)  $2^6$

B)  $2^{-4}$

C)  $2^7$

D)  $4^6$

3- Shprehja  $7a + 3b + 4a - 2b$  është e njëvlershme me shprehjen: 1 pikë

A)  $10ab + 2ab$

B)  $12ab$

C)  $11a + b$

D)  $11a + 5b$

4- Në një hartë me shkallën 1 : 50 000, 5cm tregojnë: 1 pikë

A) 250 000 km

B) 250 km

C) 25 km

D) 2,5 km

5- Plotësoni: 2 pikë

$(8^2 - 3^2) = (\dots - \dots)(\dots + \dots)$        $21^2 = (20+1)^2 = \dots\dots\dots$

6- Sa është një e katërta e numrit 16? 3 pikë

Sa është një e treta e numrit 3?

Gjeni tre të katërtat e një të dhjetës së 800 lekëve.

7- Një shishe mban  $2\frac{1}{4}$  litra lëng frutash. Sa gota me lëng frutash mund të mbushen nga

shishja, nëse çdo gotë merr  $\frac{3}{8}$  litra lëng frutash? 2 pikë

8- Një person punon  $8\frac{1}{2}$  orë në ditë. Ai kalon  $3\frac{1}{4}$  orë në takime me klientë dhe kohën e

mbetur, ai punon në zyrë. 2 pikë

a) Ç'pjesë të orëve të punës kalon ai me klientët?

b) Ç'pjesë të gjithë ditës kalon ai në zyrë?

9- ~~Z~~ Zbërtheni kllapat në shprehjet e mëposhtme dhe më pas thjeshtoni: 2 pikë

$$2(x-3y) - 3(y-2z) + 4(z-5x) =$$

10- ~~F~~ Fiona ka një kuti me çokollata në frigorifer. Motra e saj, Emilia, hëngri  $\frac{2}{5}$  e pakos dhe

vëllai i saj, Deni, hëngri  $\frac{1}{8}$  e tyre. Ç'pjesë e çokollatave mbeti për Fionën? 2 pikë


11- ~~D~~ Duke përdorur formulën  $v = u + at$ , gjeni: 2 pikë

a.  $v$ , në qoftë se:  $u = 10$ ,  $a = 2,5$  dhe  $t = 30$ .

b.  $u$ , nëse  $v = 25$ ,  $a = 4.6$  dhe  $t = 20$ .


12- ~~S~~ 4 pikë

a. Shkruani formulat për njehsimin e perimetrit dhe syprinën e figurës së dhënë.



b. Njehsoni perimetrin dhe syprinën e drejtkëndëshit nëse  $x = 5 \text{ cm}$ .

13- ~~V~~ Vizatoni pamjen plane, ballore dhe anësore për trupin: 3 pikë



14- ~~P~~ Plani i një fushe është vizatuar me shkallë 1: 5000. Dy pemë në fushë janë 420 m larg njëra-tjetrës. Sa larg do të jenë ato në plan? 2 pikë

15- ~~S~~ Sa plane simetrie ka secili prej trupave të mëposhtëm? 2 pikë

a Prizmi i rregullt me bazë pesëkëndësh.

b Prizmi i rregullt me bazë gjashtëkëndësh.

**Klasa IX Test përmbledhës, koha 45 min, mësuese Jonida Sefa, shkolla "Pjetër Budi",**

**Tiranë**

Konceptet	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënës Nxënësi	Niveli II i arritjes së	Niveli III i arritjes së komp.	Niveli IV i arritjes
-----------	----------------------	-----------------------------------	----------------------------------	---	----------------------------

		komp.	së komp.	
<b>Gjeometria</b>	19%=6 pikë	-përdor Teoremën e Pitagorës;	U 2	
		-njehson këndin rrethor dhe këndin qëndror;	U 5	
		-zgjidh situata problemore me këndet.	U 12 a) U 12 b)	
<b>Bashkësia</b>	16,5%= 5 pikë	-përdor simbolet përkatëse për bashkësitë;	U 7	
		-gjen prerjen dhe bashkimin e bashkësive.	U 11 U 16	
<b>Veprimet me numrat</b>	19% = 6 pikë	-njeh gjuhën e matematikës;	U 6	
		-kryen veprime me numrat.	U 13 a) U 13 b)	
<b>Njësitë e përbëra</b>	10% = 3 pikë	-njeh njësitë e përbëra;	U 1	
		-zgjidh situata problemore.	U 14 U 14	
<b>Paraqitja dhe interpretimi i të dhënave</b>	19% = 6 pikë	-përdor njohuritë për korrelacionin;	U 9	
		-njehson mesataren.	U 15 U 15	
<b>Raporti dhe përpjesëtimi</b>	16 ,5%= 5 pikë	-përdor raportin në situata të thjeshta;	U 3	
		-zgjidh situata me raporte.	U 10 a) U 10 b)	
<b>Pikët totale të testit</b>	100% = 32 pikë	40% = 13 pikë	40% = 13 pikë	20% = 6 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-8	9-12	13-16	17-20	21-24	25-28	29-32

Në ushtrimet 1-8 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë. Secila nga përgjigjet vlerësohet me një pikë.

1. Cila nga madhësitë është e përbërë:

- A) kg
- B) m/s
- C) g
- D) ha

2. Hipotenuza e trekëndëshit kënddrejtë dybrinjëshëm me katete a është :

- A)  $\sqrt{2}$   
B)  $2a^2$   
C)  $a\sqrt{2}$   
D)  $2a$
3. Dy burra e hapin një kanal në 10 ditë . Për sa ditë e hapin këtë kanal 5 burra nëse punojnë të gjithë njësoj?  
A) 2  
B) 4  
C) 6  
D) 8
4. Raporti i thjeshtuar i 104 mm : 7,8 cm është:  
A) 104 : 78  
B) 52:39  
C) 2:15  
D) 15:2
5. Masa e një këndi rrethor është  $80^\circ$ . Masa e këndit qëndror që mbështetet në të njëjtin hark është :  
A)  $40^\circ$   
B)  $160^\circ$   
C)  $80^\circ$   
D)  $60^\circ$
6. Gjysma e gjysmës së një numri është 16. Cili është numri?  
A) 8  
B) 4  
C) 64  
D) 32
7. Qarko pohimet e vërteta:  
A)  $-2 \in \mathbb{N}$   
B)  $3 \in \mathbb{Z}$   
C)  $\frac{1}{2} \in \mathbb{N}$   
D)  $-5 \in \mathbb{Z}^+$
8. Këndi i jashtëm i një shumëkëndëshi të rregullt është  $45^\circ$ , këndi i brendshëm është:

- A)  $180^0$
- B)  $135^0$
- C)  $90^0$
- D)  $45^0$

Në ushtrimet 9-15 jepni zgjidhjen dhe arsyetimin përkatës.

9. Plotëso:



- a) Në statistikë, kur pikat gjenden afër një drejtëze kemi të bëjmë me \_\_\_\_\_.  
(2 pikë)
- b) Me korrelacion pozitiv kemi të bëjmë kur \_\_\_\_\_.

10. Joni është 7 vjeç dhe Altini është 5 vjeç. Ata ndajnë një sasi parash në raport me moshat e tyre. Joni mori 2800 lekë më shumë se Altini.

- a) Sa mori secili? (2 pikë)
- b) Nëse ata ndajnë të njëjtën sasi parash vitin tjetër, nga sa lekë do të marrë secili? (2 pikë)

11. Janë dhënë  $n(A) = 20$ ,  $n(B) = 15$  dhe  $n(A \cap B) = 6$ . Gjej  $n(A \cup B)$ ? (2 pikë)

12. Gjeni masën e këndit x: (4 pikë)



13. Kryej veprimet:

- a)  $(3 - 0.4 \div 0.6 + \frac{1}{3}) \cdot 3 \div 0.1 =$
- b)  $[(-2)^3 + (-3)^3 \cdot (-4)^0] \cdot (-35)^{-1} =$

14. Një shtet e ka syprinën  $244000 \text{ km}^2$ . Dendësia e popullsisë është  $240 \text{ banorë/km}^2$

Sa është popullsia e këtij shteti? (2 pikë)

15. Mesatarja aritmetike e 3 numrave a, b, c është 8,5. Mesatarja aritmetike e numrave a, b, c, d është 7,5. Gjeni numrin d? (4 pikë)

16. Jepet  $A = \{x \in \mathbb{Z} / x > 1\}$  dhe  $B = \{x \in \mathbb{Z} / -1 < x < 16\}$ . Gjej: (2 pikë)

- a)  $A \cup B =$
- b)  $A \cap B =$

**Klasa IX Test 1, koha 45 min, mësuese Servete Meçaj, shkolla “Betim Muço”, Tiranë**

Konceptet	Përqindja a =Pikët	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	Niveli II i arritjes së Komp.	Niveli III i arritjes së Komp.	Niveli IV i arritjes së komp.
<b>Ekuacionet dhe inekuacionet</b>	30%=9 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ përkthen fjalitë matematikore me simbolet përkatëse;</li> <li>➤ zgjidh situatë problemore duke përdorur sistemin e ekuacioneve</li> </ul>	U2	U4a,c,d	U4b
<b>Gjeometria në hapësirë. Ndërtime gjeometrike</b>	24%=7 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ përcakton planet e simetrisë së trupave 3D;</li> <li>➤ përcakton vetinë e pingules në një pikë jashtë drejtëzës;</li> <li>➤ llogarit gjatësinë e një figure në hartë kur dihet shkalla e zvogëlimit.</li> </ul>	U1 U3	U5a,b,c	U5d,e
<b>Teorema e Pitagorës</b>	16%=5 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ plotëson barazimin që shpreh Teoremën e Pitagorës;</li> <li>➤ zbaton Teoremën e Pitagorës në situatë nga jeta reale.</li> </ul>	U6	U8a,c	U8b
<b>Paraqitja, interpretimi dhe diskutimi i të dhënave</b>	10%=3 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ analizon dhe interpreton rezultatet nga një diagram i dhënë.</li> </ul>	U10a	U10b,c	
<b>Sipërfaqja, perimetri dhe vëllimi.</b>	20%=6 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ llogarit syprinën e një figure të dhënë duke zbatuar formulën përkatëse;</li> <li>➤ llogarit syprinën e një trupi të dhënë duke zbatuar formulën përkatëse.</li> </ul>	U7	U9a,c	U9b
<b>Pikët totale të testit</b>	<b>30 pikë</b>		<b>40%=12 pikë</b>	<b>40%=1 2 pikë</b>	<b>20%=6 pikë</b>

**Tabela e pikëve**

<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10
<b>Pikët</b>	< 7	7-10	11-14	15-18	19-22	23-26	27-30

1. Qarko alternativën e saktë. Cilindri ka:

1 pikë

A) Dy plane simetrie.

- B) Katër plane simetrie.
- C) Pafundësi planesh simetrie.
- D) Një plan simetrie.

2. Lidhni bashkësitë me simbolet përkatëse:

5 pikë

Bashkësia e numrave realë pozitivë më të mëdhenj se 8
Bashkësia e numrave më të mëdhenj se $-4$ , por më të vegjël se 3
Bashkësia e numrave realë negativë më të vegjël se $-6$
Bashkësia e numrave realë pozitivë më të vegjël ose të barabartë me 7
Bashkësia e numrave realë

$\{x \in \mathbb{R} / x < -6\}$
$]0;7]$
$]8;+\infty[$
$] -\infty;+\infty[$
$] -4;3[$

3. Nga një pikë jashtë një drejtëze hiqet:

1 pikë

- A) Vetëm një pingule me drejtëzën e dhënë.
- B) Një pafundësi pingulesh me drejtëzën e dhënë.
- C) Një e pjerrët me drejtëzën e dhënë.
- D) Dy pingule me drejtëzën e dhënë.

4. Biletat e udhëtimit për 3 të rritur dhe 5 fëmijë kushtojnë 285 lekë. Biletat për 2 të rritur dhe 3 fëmijë kushtojnë 179 lekë.

4 pikë

- a. Shkruani sistemin e ekuacioneve për këto të dhëna.
- b. Zgjidhni sistemin e ekuacioneve.
- c. Gjeni çmimin e biletave për të rritur.
- d. Gjeni çmimin e biletave për fëmijë.

5. Një kompleks sportiv në formë trapezi me bazë të madhe 200m, me bazë të vogël 120m dhe me lartësi 80m është paraqitur në një hartë me shkallën 1:2 000 000. Gjeni:

5 pikë

- a. Gjatësinë e bazës së madhe në hartë.
- b. Gjatësinë e bazës së vogël në hartë.
- c. Gjatësinë e lartësisë në hartë.
- d. Syprinën në hartë të kompleksit sportiv.
- e. Syprinën reale të kompleksit sportiv.



6. Plotëso fjalinë:

2 pikë

Në çdo trekëndësh kënddrejtë katrori i \_\_\_\_\_ është i barabartë me \_\_\_\_\_ e katrorëve të kateteve.

7. Qarko alternativën e saktë. Perimetri i katrorit është  $8a$ . Syprina e tij është:

1 pikë

A)  $4a^2$

B)  $16a$

C)  $8a^2$

D)  $8a$

Argumento përgjigjen \_\_\_\_\_

1 pikë

8. Një anije në fillim lundron  $60$  km në jug dhe pastaj  $48$  km në perëndim.

3 pikë

- Skico figurën për këtë lëvizje të anijes.
- Zbato Teoremën e Pitagorës për figurën e skicuar.
- Gjej sa larg nga vendi i nisjes gjendet anija?

9. Një enë në formë kuboidi si ajo në figurë është mbushur plot me ujë. Më pas zbrazet në cilindrin me rreze  $12$  cm. Gjenero:

a. Vëllimin e kuboidit.



1 pikë

b. Deri në ç' lartësi mbushet cilindri me ujë?

2 pikë

c. Jepni përgjigjen në milimetrin më të afërt.


1 pikë



10. Grafiku i mëposhtëm tregon pikët e marra në një testim për një grup nxënësish të një shkolle.

3 pikë

Vrojtoni grafikun dhe nxirrni 3 përfundime nga ai.



Klasa IX Test

2, koha 45 min,

mësuese Servete Meçaj, shkolla “Betim Muço”, Tiranë

Konceptet	Përqindja =Pikët	Rezultatet e të nxënët Nxënësi:	Niveli II i arritjes së Komp.	Niveli III i arritjes së Komp.	Niveli IV i arritjes së komp.
<b>Bashkësia</b>	14%=4 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ paraqet bashkësinë numerike me emërtim,përshkrim;</li> <li>➤ gjen prerjen ose bashkimin e dy bashkësive.</li> </ul>	U3	U1	
<b>Numrat racional. Fuqitë dhe rrënjët</b>	17%=5 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ njehson vlerën e një shprehje numerike;</li> <li>➤ njehson rrënjën katrore dhe rrënjën kubike të numrave;</li> <li>➤ njehson vlerën e një shprehjeje numerike të përbëre.</li> </ul>	U4	U2	U6
<b>Shprehjet algjebrike</b>	20%=6 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ ndërton shprehje algjebrike për situata të dhëna;</li> <li>➤ shumëzon binome dhe i kthen ato në trajtë të rregullt.</li> </ul>	U5a	U5b,c U7	
<b>Gjeometri. Figurat gjeometrike.</b>	12%=4 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ njehson masën e këndeve të një shumëkëndëshi;</li> <li>➤ njehson këndet që mungojnë në një figurë.</li> </ul>	U12a	U12b	U12c
<b>Numrat thyesorë,nu mrat dhjetorë.</b>	21%=6 pikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ zgjidh situatë problemore me veprime me thyesa;</li> <li>➤ shumëzon dhe pjesëton numra dhjetorë.</li> </ul>		U9 U8	U10

<b>Grumbullimi I të dhënave.</b>	7%=2 pikë	➤ saktëson pyetjet e sugjeruara për një studim statistikor.	U11		
<b>Gjatësia, masa, vëllimi.</b>	9%=3 pikë	➤ zgjidh problema nga jeta reale ku përdoren njësitet e matjes së gjatësisë.	U13		
<b>Pikët totale të testit</b>	<b>30 pikë</b>		<b>40%=12 pikë</b>	<b>40%=12 pikë</b>	<b>20%=6 pikë</b>

**Tabela e pikëve**

<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10
<b>Pikët</b>	< 7	7-10	11-14	15-18	19-22	23-26	27-30

- Jepet bashkësia  $A = \{x \in \mathbb{N} \mid x < 20\}$  dhe  $B = \{x \in \mathbb{N} \mid x > 10\}$ . Qarko alternativën e saktë.  
Prerja e bashkësisë A me bashkësinë B është bashkësi: 1 pikë
  - $C = \{x \in \mathbb{N} \mid x > 10\}$
  - $D = \{x \in \mathbb{N} \mid 10 < x < 20\}$
  - $E = \{11; 12; 13; 14; 15\}$
  - $F = \{x \in \mathbb{N} \mid x < 20\}$
- Qarko alternativën e saktë: Vlera e shprehjes  $(-5)^2 \times (+3)$  është: 1 pikë
  - 75
  - 8
  - 75
  - 57
- Jepet bashkësia  $A = \{-2; +5; -0,6; +1,8; 0; +3,1; +2,4; -1,2\}$ . Paraqitni me emërtim nënbashkësitë e dhëna me përshkrim. 3 pikë

$$B = \{x \in A \mid x < +1\}$$

$$C = \{x \in A \mid x \geq +1\}$$

$$D = \{x \in A \mid x \leq 0\}$$
- Zgjidhni njëren nga 4 fjalët e mëposhtme, që të jenë të vërteta pohimet: 2 pikë

**Kub , rrënjë katrore , katror, rrënjë kubike**

- \_\_\_\_\_ i 14-ës është 196
- \_\_\_\_\_ e 125-ës është 5

5. Një katror e ka gjatësinë e brinjës  $x+2$  cm. Shkruani shprehjen për: 3 pikë
- Perimetrin e katrorit
  - Syprinën e katrorit
  - Thjeshtoni shprehjen e perimetrit dhe syprinës

6. Gjeni vlerën e shprehjes: 2 pikë

$$\left(\frac{3}{5} - \frac{1}{2} - \frac{1}{10}\right)^{-2} \times \left(\frac{3}{4} - \frac{1}{3}\right) =$$

7. Çifto prodhimin e binomeve me trajtën e tyre të thjeshtuar. 3 pikë

$(x-1)(x+6)$
$(x+3)(x-2)$
$(x-6)(x-1)$

$x^2-5x+6$
$x^2-7x+6$
$x^2+5x-6$
$x^2+x-6$

8. Tre kandidatë për krytarë bashkie në një qytet morën këto pjesë të votave: 2 pikë

I pari mori  $\frac{5}{12}$  e votave dhe i dyti  $\frac{7}{36}$  e votave.

- Ç'pjesë të votave mori i treti?
- Cili nga kandidatët i fitoi zgjedhjet?

9. Plotësoni me fuqitë e dhjetës, që të merrni barazime të vërteta. 2 pikë

a)  $0,0077 \times \underline{\hspace{2cm}} = 7,7$

b)  $67 : \underline{\hspace{2cm}} = 0,067$

10. Serbatori i një makine përmban 79,95 naftë. Makina harxhon 9,75 litra naftë për çdo 100 km. Gjeni sa km bën makina me këtë naftë. Argumentoni përgjigjen. 2 pikë

11. Ana po bën një studim për të gjetur nëse paratë e xhepit të nxënësve kanë lidhje me moshën. Pyetja e saj është: 'Sa vjeç jeni?' dhe i grupoi sipas këtyre kategorive. 2 pikë


- Nën 5 vjeç
- 6 deri 10 vjeç
- 10 deri 13 vjeç
- 13 deri 16 vjeç
- mbi 16 vjeç.

Shkruani dy situata problemore në lidhje me kategorinw B dhe D.

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_

12. Është dhënë pesëkëndëshi i mysët më poshtë.

- a) Shkruani barazimin që shpreh shumën e këndeve të tij. 1 pikë
- b) Zgjidhni ekuacionin e formuar. 1 pikë
- c) Gjeni masën e këndeve të 5-këndëshit. 2 pikë



13. Largesa nga qyteti A për në qytetin B është 190 kilometra. Largesa nga qyteti A për në qytetin C është 128 milje. 3 pikë
- a) Ktheni 128 milje në kilometra.
- b) Jepni përgjigjen në numrin e plotë më të afërt.
- c) Cili është më larg nga qyteti A, qyteti C apo qyteti B? Sa më larg?

## V. PYETJE ME SITUATA NË AMU QË MUND TË PËRDOREN NË TESTE

### Klasa VI, mësuese Arta Mezuri , Vlorë

1. Një arkë ka 8 kg pjeshkë. Nëse në makinë u vendosën 9 rreshta me 120 arka secili, sa kg pjeshkë u ngarkuan në makinë? (1 pikë/\_\_\_\_)
- A) 1032 kg
- B) 1152 kg
- C) 2040 kg
- D) 8640 kg
2. Një varkë mban 80 kg. Agimi peshon 30 kg, Beni 35 kg, Blerina 25 kg dhe Artani 52 kg. Cili nga kombinimet e mëposhtme të peshave të fëmijëve mund të vozisë me varkë? (1 pikë/\_\_\_\_)
- A) Agimi me Artanin.
- B) Agimi, Beni dhe Blerina.
- C) Beni me Artanin.
- D) Agimi me Blerinën.

3. Një kilogram mollë kushton 60 lekë. Drita shiti 10 arka me nga 15 kg secila. Ajo grumbulloi 9000 lekë. Qarko e vërtetë apo e gabuar. **(1 pikë/\_\_\_)**

V G

4. Nga bashkësia  $A = \{-3, 2, 11, 0, -6, \frac{2}{3}, -1\}$  shkruajmë nënbashkësinë  $B = \{-3, -6, -1\}$ .  
Plotësoni fjalinë: Këta numra i përkasin bashkësisë së numrave të plotë ..... **(1 pikë/\_\_\_)**

5. Nxënësit e klasës së gjashtë A bënë një studim mbi stinën e preferuar të nxënësve të klasave të teta. Të dhënat janë paraqitur në tabelën e dendurisë.

Stina	Denduria
Pranverë	10
Verë	24
Vjeshtë	6
Dimër	4

- a) Vrojto tabelën. Cila është stina më e preferuar e nxënësve? **(1 pikë/\_\_\_)**
- b) Cila është stina më pak e preferuar? **(1 pikë/\_\_\_)**
- c) Paraqit të dhënat në diagram me shtylla. Një kuti paraqet 2 nxënës **(2 pikë/\_\_\_)**
6. Bora ka 200 lekë. Ajo dëshiron të blejë sendet që kushtojnë 70 lekë, 90 lekë dhe 50 lekë.
- a) A mund t'i blejë të treja sendet Bora? **(1 pikë/\_\_\_)**
- b) Sa lekë do t'i kthejë shitësja po të blejë dy sendet e para? **(1 pikë/\_\_\_)**
- c) Po sikur të blejë sendin e dytë dhe të tretë, sa lekë do t'i kthejë shitësja? **(1 pikë/\_\_\_)**
- d) Bora dëshiron të blejë dhe një kapëse që kushton 25 lekë. Dhe sa lekë do t'i duhen Borës për të blerë të katërta sendet? **(1 pikë/\_\_\_)**
7. Isha në treg për të blerë disa sende. Në fillim shpenzova  $\frac{2}{3}$  e lekëve që kisha dhe më vonë dhe  $\frac{1}{4}$  e tyre. Më tepruan 45 lekë. Sa lekë kisha në fillim? **(3 pikë/\_\_\_)**
8. Paga e një punëtori ishte 35000 lekë. Ajo pësoi dy ndryshime. Në fillim u rrit me 30%. Më pas u ul me 8 % të pagës së re. Gjeni sa lekë u bë paga e punëtorit pas dy ndryshimeve. **(2 pikë/\_\_\_)**

9. Mësuesi i historisë iu kërkoi nxënësve të bëjnë lidhjen e datave historike të dhëna me numra me ato të dhëna me shifra romake. Si mendoni se duhen lidhur lidhur ato?

(4 pikë/\_\_\_\_)

1354	CMLXXII
972	MCCCLIV
584	DXCVI
2006	DLXXXIV
	MMVI

10. Në orën e matematikës, Miri e zgjidhi ushtrimin si më poshtë. Gjeni nëse Miri ka vepruar mirë apo gabim.


(4 pikë/\_\_\_\_)

$42 \cdot 10 = 4200$	V	G
$567 : 100 = 5,67$	V	G
$4.37 \cdot 100 = 43.7$	V	G
$3345,7 : 1000 = 3,3457$	V	G

### Klasa VI, mësuese Dashamira, Berat

1. Balona e parë me ajër të ngrohtë është ngritur në qiell në vitin xxxx. Gjej vitin duke përdorur këtë çelës: 2 pikë
- a) Kur ti e rumbullakos në dhjetëshen më të afërt gjen numrin 1780;
- b) Kur ti i mbledh shifrat e vitit gjen shumën 19.
2. 1 kg mollë kushton 120 lekë.
- Lidh me shigjetë masën në kg me lekët e shpenzuara në çdo rast: 5 pikë
- |    |                   |   |   |          |   |
|----|-------------------|---|---|----------|---|
| A. | 5 kg              | * | * | 30 lekë  | a |
| B. | 2,5 kg            | * | * | 420 lekë | b |
| C. | $\frac{1}{4}$ kg  | * | * | 300 lekë | c |
| D. | 0,75 kg           | * | * | 90 lekë  | d |
| E. | $3\frac{1}{2}$ kg | * | * | 600 lekë | e |
|    |                   |   | * | 200 lekë | f |

3. Nga qyteti A në B ka 9 stacione të autobusit, ku largesa nga njëri stacion në stacionin fqinjë është e njëjtë. Largesa nga stacioni i dytë deri tek stacioni i pestë është 6 km. Sa km është larg stacioni i parë nga ai i nënti? 1 pikë
- A) 12 km  
B) 14 km  
C) 16 km  
D) 18 km
4. Një prodhues i vezëve ka dy lloje kutish, më të vogla në të cilën futen 6 vezë dhe më të mëdha në të cilën futen 12 vezë. Kush është *numri më i vogël i kutive* që do të përdor ai për të vendosur 66 kokrra vezë? 1 pikë
- A) 5  
B) 6  
C) 8  
D) 11
5. Anakonda është gjarpri më i madh në Tokë, i cili është përafërsisht 11 metër i gjatë dhe mund të jetojë afro 50 vjet. Nëse doni të gjeni masën e përafërt të anakondës zgjidh ekuacionin:  $80329 - 5x = 79579$  2 pikë
6. Katër tulla të njëjta me gjatësi 20 cm dhe gjerësi 12 cm janë renditur si në figurë. Perimetri i katrorit të formuar ndërmjet tyre është: 1 pikë



- A) 24 cm  
B) 28 cm  
C) 32 cm  
D) 36 cm
7. Një polumbar zhytet 18 m në thellësi, ngjitet 7 m lart, zbret sërish 12 m, ngrihet lart 2 m dhe së fundmi zbret 3 m. Gjeni se në ç'thellësi arrin polumbari? 3 pikë
8. Nëse një foshnje për një ditë pi 6 dl qumësht, atëherë sa litra qumësht do të pijë foshnja prej 1 janarit deri në 14 shkurt. 3 pikë



9. Lugët plastike vendosen në kuti me 6 copë, pirunjtë plastike në kuti me nga 8 copë dhe thika plastike në kuti me nga 12 copë. Cili është numri më i vogël i kutive me lugë, me pirunj dhe me thika që të formosh komplete me të tria këto mjete? 3 pikë

10. Një grup alpinistësh vendosën të ngjiten në majën e Tomorrit që është 2417 m e lartë. Grupi u nis nga lartësia 617 m. Në orën e parë përshkoi  $\frac{3}{5}$  e lartësisë që kishte për t'u ngjitur. Në orën e dytë  $\frac{5}{9}$  e lartësisë që kishte mbetur. Në orën e tretë  $\frac{19}{32}$  e lartësisë që mbeti nga ora e dytë. Në orën e katërt ngjitën pjesën e fundit. Sa metra u ngjitën në orën e katërt?

3 pikë

**Klasa VI, mësuese Irena Tafani, shkolla "Naim Frashëri", Elbasan**

Qarkoni përgjigjen e saktë.

1. Era është jo më e madhe se Mira dhe Mira është jo më e madhe se Era: 1 pikë

- A) Era është më e vogël se Mira.
- B) Mira është më e madhe se Era.
- C) Era dhe Mira janë në të njëjtën moshë.

2. Shënoni e vërtetë apo e gabuar ( V/G) 4 pikë

- |   |   |   |
|---|---|---|
| a) Shuma e pesë numrave tek është numër çift.                 | V | G |
| b) Prodhimi i 3 numrave tek është numër tek.                  | V | G |
| c) Shuma e 2 numrave tek me dy numra çift është numër tek.    | V | G |
| d) Prodhimi i 2 numrave çift me 3 numra tek është numër çift. | V | G |

3. Lidhni me shigjetë:

Syprinën me njësinë e duhur për matjen e saj.

<p>Syprina e qytetit</p> <p>Syprina e tryezës</p> <p>Syprina e shkollës</p> <p>Syprina e librit</p>	<p><math>cm^2</math></p> <p><math>mm^2</math></p> <p><math>dm^2</math></p> <p><math>km^2</math></p> <p><math>m^2</math></p>
---	---

4 pikë

4. Përmasat e një fotoje janë 20cm me 60cm. Fotoja do të përpunohet dhe përmasat e fotos së re do të jenë sa  $\frac{1}{4}$  e përmasave të fotos fillestare. Gjeni:

- a) Sa do të jetë syprina e fotos së re? **1 pikë**
- b) Sa do të jetë perimetri i fotos së re? **1 pikë**
5. Era niset në një udhëtim për në Kanada. Udhëtimi i saj do të ndjekë itinerarin Tiranë – Frankfurt – Toronto. Në Frankfurt, ora tregon të njëjtën orë me Tiranën, në Toronto 6 orë më pak. Era niset nga aeroporti në 01:15 të pasdites. Udhëtimi i parë zgjat 2 orë e 35 minuta, udhëtimi i dytë zgjat 8 orë e 20 minuta. Duke ditur që pushon në Frankfurt 3 orë e 15 minuta, gjeni orën e mbërritjes në Kanada me orën lokale. **2 pikë**

**Veprime me kartmonedha**

6. Në vitrinën e një dyqani në Tiranë janë vendosur çmimet për artikuj.

Artikulli	Pulovër	Pantallona	Çantë	Atlete	Kasketë	Xhaketë
Çmimi	47 €	42 €	35,90 €	49 €	11,20 €	59,50 €

- a) Artani pagoi me një kartëmonedhë 20 euro, një kartëmonedhë 10 euro, një kartëmonedhë 5 euro, një monedhë 50 cent dhe 2 monedha 20 centëshe. Cilët artikuj mund të ketë blerë ai?

**2 pikë**

- b) Blendi dha një kartëmonedhë 50 € për të blerë njërin nga këto artikuj dhe mori 8 €. Cilët artikuj mund të blerë ai?

**2 pikë**

7. Andi do të blejë një TV 3D. Ai shikon reklamën :

Andi zgjedh mënyrën e dytë. Gjeni

- a) Sa duhet të paguajë në fillim dhe sa do të paguajë gjithsej.  
b) A ka bërë Andi zgjedhjen më të mirë?

Çmimi 800 euro
Ose
30% të çmimit të fillimit dhe 10 këste mujore nga 60 euro.

8. Tabela e mëposhtme jep masën e 1 cm<sup>3</sup> të secilit metal.

metali	Alumin	Argjend	Bakër	Kallaj	Hekur	Ar
Masa e 1 cm <sup>3</sup>	2,7 g	10,5 g	8,920 g	7,29 g	7,86 g	13,3 g

Radhitni masat e 1 cm<sup>3</sup> për secilin metal në rendin zbritës.

**2 pikë**

9. Në tabelën e mëposhtme jepen rrezet (në mijë km) e planetëve të Sistemit Diellor.

Planeti	Toka	Neptuni	Mërkuri	Marsi	Jupiteri	Venusi	Urani	Saturni
Rrezja (në mijë km)	6,378	25,269	2,439	3,397	71,49	6,052	25,559	60,268

Radhitni planetet në rendin rritës të rrezeve të tyre.

**2 pikë**

**10.** Gjerësia e një fushe tenisi për ndeshjet individuale është 23,77 m. Për ndeshjet dyshe shtohen dy korridore anësore me gjerësi 137 cm secili. Sa është gjerësia e fushës së tenisit për ndeshjet dyshe?

**2 pikë**

**Klasa VI, mësuese Angjelina Gjergji, Lezhë**

**1.** Dy punëtorë ndërtojnë së bashku një mur. Po të punonte vetëm punëtori i parë, do ta mbaronte murin në 10 ditë dhe po të punonte vetëm i dyti, do ta mbaronte në 8 ditë. Sa pjesë të murit do të ndërtonin të dy punëtorët së bashku për 1 ditë?

**1 pikë**

A)  $\frac{8}{10}$

B)  $\frac{10}{80}$

C)  $\frac{9}{40}$

D)  $\frac{18}{40}$

**2.** Në vazhdimin e punës për të ndërtuar murin, por jo për ta përfunduar plotësisht, sa pjesë të murit do të ndërtonin të dy punëtorët së bashku në 4 ditë?

**1 pikë**

A)  $\frac{7}{10}$

B)  $\frac{8}{10}$

C)  $\frac{9}{10}$

D)  $\frac{18}{10}$

**3.** Njëra nga menutë e një restoranti për një person është:

**2 pikë**

1 peshk me patate që kushton 200 lekë,

1 sallatë që kushton 100 lekë,

1 akullorë që kushton 200 lekë

dhe 1 koka-kola që kushton 140 lekë.

Nëse klienti porosit këtë menu dhe 10 % të faturës për shërbimin, sa lekë do të paguajë ai?

**4.** Në një dyqan jepen çmimet e disa artikujve në euro.

Artikulli	Pulovër	Pantallona	Pallto	xhinse	çantë	kostum	Këpucë
çmimi	32,5 €	50,6 €	72 €	40,2 €	30,4 €	150,5 €	46,52 €

- a) Radhitni çmimet e artikujve në rendin rritës. 1 pikë
- b) Nëse Genti blen 1 pulovër, 1 palë xhinse dhe 1 palë këpucë, sa euro shpenzon ai? 1 pikë
- c) Çmimi i palltos ulet me 22 euro. Sa % u ul çmimi? 1 pikë  
Çmimet e pantallonave, çantës dhe kostumit ulen me 10 %.
- d) Gjeni shumën e çmimeve të këtyre artikujve pas uljes? 3 pikë


### Pyetje me V dhe G.

5. Zgjidhni alternativën (V) kur fjalia është e vërtetë dhe (G) kur ajo është e gabuar. 4 pikë

- a) Pika (3;0) ndodhet në boshtin OX.
- b) Pika (-2;3) ndodhet në kuadratin e dytë.
- c) Pika (5;-4) ndodhet në kuadratin e dytë.
- d) Pika (7;0) ndodhet në boshtin OY.

V	G
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

6. Lidh me shigjetë A me B në mënyrë që barazimi të jetë i vërtetë: 4 pikë



7. Duke ditur vetitë e figurave gjeometrike si: **katrori, drejtkëndëshi, paralelogrami, rombi, trapezi dhe balona**, plotësoni vendet bosh me emrat e figurave: 6 pikë
- a) Ka një çift brinjësh paralele \_\_\_\_\_
- b) Këndet e kundërta i ka të barabarta \_\_\_\_\_
- c) Ka katër kënde të drejta \_\_\_\_\_

- d) Nuk i ka brinjët paralele \_\_\_\_\_
- e) I ka të gjitha brinjët me gjatësi të barabartë \_\_\_\_\_
- f) I ka diagonalet pingule \_\_\_\_\_

### Klasa VII, mësuese Arta Mezuri, Vlorë

1- Një klasë ka 16 vajza, që përbëjnë 40% të nxënësve të klasës.  $\frac{2}{3}$  e djemve të klasës luajnë basketboll.




- a) Gjeni sa nxënës ka klasa. **(1 pikë)**
- b) Gjeni sa djem **nuk** luajnë basketboll. **(2 pikë)**

2- Në një kuti prej 0,5kg ushqim për mace, Adi përdor për macen e tij vetëm 200g ushqim në ditë. Llogaritni sa kuti duhet të blejë Adi për një javë. **(3 pikë)**

3- Për mirëmbajtjen e një lulishteje, një kopshtar kërkon një pagesë fikse prej 80€ shtuar shumës 40€ për çdo orë pune. Formula që llogarit pagën S (në Euro) në varësi të kohës t është: **(1 pikë)**

- A)  $S = 40t - 80$
- B)  $S = 80t + 40$
- C)  $S = 40t + 80$
- D)  $S = 40 - 80t$

4- Gjej numrin që mungon në modelin e mëposhtëm **(1 pikë)**



5- Lidhni me shigjetë shprehjet e listës A me shprehjet e listës B që kanë të njëjën vlerë.

**(4 pikë)**

#### Lista A

$$3(5 - 2x)$$

$$4(y+5x)$$

$$2(x+2y - 7)$$

#### Lista B

$$-6x+3y$$

$$15 - 6x$$


$$4y + 20x$$

$$3(2x - y)$$

$$2x + 4y - 14$$

$$15x + 6y$$

- 6- Përcaktoni vlerën e  $x$ -it nga figura duke njohur masat e këndeve të trekëndëshit. (3 pikë)



- 7- Nga një studim i kryer rreth përdorimit të burimeve të energjisë në rang botëror në vitin 2016 u morën këto të dhëna: *Qymyri përdoret 23%, nafta përdoret 33%, gazi përdoret 20%, biomasa 12%, energjia bërthamore 8%, energjia e ujit 3%, burime të tjera të ripërtëritshme 1%.*

- a) Ndërtoni një diagram rrethor për të dhënat e këtij studimi. (2 pikë)
- b) Shprehni mendimin tuaj rreth përparësive që kanë burimet e ripërtëritshme të energjisë. (2 pikë)
- 8- Ndërtoni në rrjetin koordinativ një trekëndësh me kulme  $A(-3; 1)$   $B(2; 1)$   $C(4; 2)$ .
- a) Ndërtoni simetrikun e këtij trekëndëshi në lidhje me boshtin  $Oy$ . (1 pikë)

- b) Zhvendosni trekëndëshin fillestar 1 njësi majtas dhe 2 njësi lart dhe shkruani koordinatat e kulmeve të trekëndëshit të përfutur  $A_1B_1C_1$ . (2 pikë)

- 9- Rregulla e formimit të vargut është ‘‘ Shumëzo me 3 dhe zbriti 2’’. Kufiza e tij e tretë është 13.

- a) Gjeni kufizën e parë të vargut. (2 pikë)
- b) Gjeni kufizën e 50-të të vargut. (1 pikë)

- 10- Tregoni nëse gjenden në grafikun e funksionit  $y = 5x + 2$ , pikat  $A(2; 7)$  dhe  $B(3; 17)$

(2 pikë)

### Klasa VII, mësuese Dashamira, Berat

1. Unë nuk mbaj mend sa e gjatë është Albana ( $x$ ), as sa i gjatë është Ardi ( $y$ ), por di se Ardi është 3 cm më i gjatë se Albana. Cila nga barazimet e mëposhtme është e vërtetë? 1 pikë

A)  $y = x - 3$

B)  $y = x + 3$

C)  $x = y + 3$

D)  $x - y = 3$

2. Një kallëp sapuni i ka përmasat 4 cm x 6 cm x 8 cm.

Sa kallëpe sapuni nxë një kuti me përmasa 40 cm x 60 cm x 80 cm.

1 pikë

A) 10

B) 100

C) 1 000

D) 10 000

3. Shigjeta e peshores rrotullohet (anon)  $80^0$  për 1 kg.

– Lidh me shigjetë masën (kg) me rrotullimin e shigjetës ( $^0$ ):

4 pikë

F.  $\frac{1}{2}$  kg \* \*  $180^0$  a

G. 300 g \* \*  $36^0$  b

H.  $2\frac{1}{4}$  kg \* \*  $40^0$  c

I. 450 g \* \*  $200^0$  d

\*  $24^0$  e

4. Kam 2 enë me qumësht.

3 pikë

– Të parës me 800 g qumësht i kam hedhur 40 g sheqer.

– Të dytës me 500 g qumësht i kam hedhur 20 g sheqer.

– Cila është më e ëmbël? Shpjegoni pse?

5. Shokët po grumbullojnë lekë për një udhëtim turistik.

– Deri tani – tha Drita – kemi mbledhur 10 000 lekë.

– Unë po shtoj edhe 20 % të këtyre lekëve – tha Andi.


– Kurse unë – tha Suela – po shtoj 20 % të lekëve që u bënë bashkë me lekët e Andit.

a) Pa kryer njësimet parashiko a ka dhënë po aq lekë Andi dhe Suela? Shpjego pse? 2 pikë

b) Kontrolllo parashikimin tënd. 2 pikë

6. Radha e parë e sallës së teatrit ka 5 vende. Çdo radhë, më pas ka dy vende më shumë se radha para saj. Salla ka 28 radhë. Sa vende ka ajo? 3 pikë

7. Një lulishte me përmasa 50 m x 60 m ka në qendër një shatërvan. Ne nuk mund ta masim në mënyrë të drejtpërdrejtë diagonalen e drejtkëndëshit. Vizato figurën të zvogëluar dhe gjej në metra gjatësinë e diagonales. 5 pikë
8. Virusi kompjuterik është program i cili mund të fshijë të dhënat nga disku i kompjuterit. Një virus i tillë ditën e parë e fshiu gjysmën e të dhënave, ditën e dytë fshiu  $\frac{1}{3}$  e të dhënave të mbetura, kurse ditën e tretë fshiu  $\frac{1}{4}$  e të dhënave që kanë mbetur pa u fshirë gjatë dy ditëve të para. Sa % e të dhënave kanë mbetur në disk. 4 pikë
9. Formula për shndërrimin e temperaturës nga celcius në Fareheit është:  $C = \frac{5}{9}(F - 32)$ .
- a) Cila temperaturë në  $^{\circ}\text{C}$  i përgjigjet temperaturës  $68^{\circ}\text{F}$ ? 2 pikë
- b) Cila temperaturë në  $^{\circ}\text{F}$  i përgjigjet temperaturës  $25^{\circ}\text{C}$ ? 2 pikë
10. Një punëtor punon 4 ditë dhe ditën e pestë e bën pushim. N.q.s. sot është e shtunë dhe ai e ka pushim, pas sa ditësh ai do të bëjë pushim përsëri të shtunën? 3 pikë
11. Në figurë janë dy rrugë për të shkuar nga A në B, njëra nëpër shkallë, tjetra nga A në M dhe nga M në B. Cila nga këto rrugë është më e gjata? Arsyeto përgjigjen. 3 pikë



**Klasa VII, mësuese Irena Tafani, shkolla “Naim Frashëri”, Elbasan**

1. Tabela e mëposhtme jep çmimet e disa artikujve në euro.

Artikulli	Pulovër	Xhinse	Pallto	Çanta
çmimi	35€	30€	72€	?



- a) Çmimi i pulovrës u ul me  $\frac{1}{5}$ , i xhinseve me  $\frac{1}{3}$ , i palltos me  $\frac{1}{4}$ . Gjeni sa euro më pak kushtojnë një pulovër, një palë xhinse dhe një pallto. **3 pikë**
- b) Çmimi i çantës është ulur me 15€, që është sa  $\frac{1}{4}$  e çmimit. Gjeni sa € ishte çmimi i çantës. **2 pikë**
- c) Turisti eci më këmbë 1,5 orë. Gjysmën e orës së parë ai eci me shpejtësi 5,4 km/orë, pastaj për 48 minuta eci me shpejtësi 4,5 km/orë. Në pjesën tjetër të kohës ai eci me shpejtësi 5 km/orë. Sa rrugë bëri turisti gjatë kohës 1,5 orë? **2 pikë**
2. Një sasi eurosh do të ndahen ndërmjet tre shokëve Arbrit, Bardhytit dhe Zanës. Secili nga ne do të marrë nga  $\frac{3}{10}$  e eurove - tha Arbri. Jo – tha Bardhyti, - secili nga ne do të marrë nga  $\frac{30}{100}$  e eurove. Ndërsa Zana mendon që secili prej tyre të marrë nga 0,3 pjesë të eurove ose 0,30. Argumentoni. **2 pikë**
3. Një pajisje elektrike kushton 25 euro. Çmimi i saj ulet me 20%. Gjeni:
- a) Me sa euro u ul çmimi. **1 pikë**
- b) Çmimin e ri të paisjes elektrike. **1 pikë**
- c) Nëse Agimi mer dy pajisje të tilla, do i blejë me 6 euro më pak se çmimi fillestar secilën. Gjeni sa % do të ulet çmimi? **2 pikë**
4. Pika më e lartë e Tokës ku mund të shkelë këmba e njeriut është maja e malit Everest, 8848 metra. Pika më e ulët e tokës është në bregun e Detit të Vdekur, 393 metra thellësi. Cili është ndryshimi ndërmjet këtyre dy lartësive? **2 pikë**
5. Në një stacion meteorologjik në Arktidë, u regjistrua temperatura  $-23^{\circ}\text{C}$ . Dy orë më vonë temperatura ra me  $8^{\circ}\text{C}$ .
- a) Gjeni se sa u bë temperatura. **1 pikë**
- b) Katër orë pas leximit të parë të temperaturës, ajo u bë  $-41^{\circ}\text{C}$ . Me sa gradë kishte rënë temperatura pas katër orësh. **1 pikë**
6. Temperatura e ngurtësimit të amoniakut është  $-78^{\circ}\text{C}$ . Gjeni:
- a) Temperaturën e ngurtësimit të mërkurit, nëse ajo është  $39^{\circ}\text{C}$  më e lartë. **1 pikë**
- b) Temperaturën e ngurtësimit të alkolit, nëse ajo është  $21^{\circ}\text{C}$  më e lartë se temperatura e ngurtësimit të amoniakut. **1 pikë**
7. Mali Everest është mali më i lartë i vargmaleve të Himalajës dhe maja e tij vendi më i lartë i

Tokës mbi sipërfaqen e detit, me lartësi 8.848 metra. Oqeani Paqësor është oqeani me një thellësi maksimale prej 11.034 m, është njëkohësisht edhe oqeani më i thellë. Gjeni largesën ndërmjet këtyre dy pikave. **2 pikë**

8. Sasia e rekomanduar për nevojat ditore me vitaminë B12 për një të rritur është  $2,4 \cdot 10^{-4}$ g, ndërsa për jodin është  $1,5 \cdot 10^{-4}$ g. Cila prej këtyre dy sasive është më e madhe? **2 pikë**

9. Madhësia e tokës është rreth 510 milion  $\text{km}^2$ . Dihet se 361 milion  $\text{km}^2$  e sipërfaqes së tokës janë të mbuluara me ujë kurse 149 milion  $\text{km}^2$  janë të mbuluara me tokë. Gjeni:

a) Ç'pjesë e tokës është e mbuluar me ujë. **1 pikë**

b) Ç'pjesë e tokës është tokë e thatë. **1 pikë**

c) Gjeni raportin e pjesës së mbuluar me ujë me pjesën që është tokë e thatë. **1 pikë**

10. Një djalë përdor ujin e mbledhur të shiut për disa nevoja të familjes së tij. Një ditë ai harxhoi nga ky ujë: **2 pikë**

250 cl për të pirë qeni;

12000 cl për të ujitur kopshtin;

150 l për të pastruar veturën.

Sa l ujë ka harxhuar ai?

### Klasa VII, mësuese Angjelina Gjergji, Lezhë

1. Fluturimi i avionëve nga Shqipëria për në Gjermani është çdo 3 ditë, kurse për në Itali është çdo 2 ditë dhe për në Angli çdo 4 ditë. Sot do të fluturojnë njëkohësisht avionët e të tre këtyre linjave. Pas sa ditësh do të fluturojnë në të njëjtën ditë të tre këta avionë? **1 pikë**

A) 8 ditësh

B) 9 ditësh

C) 10 ditësh

D) 12 ditësh

2. Nëse të tre avionët e këtyre linjave fluturojnë të shtunën, në çfarë dite do të fluturojnë përsëri në të njëjtën ditë? **1 pikë**

A) E hënë

B) E mërkurë

C) E enjte

D) E premte

3. **Katorrët** më poshtë janë formuar sipas një rregulle. Çili numër mungon?

1 pikë

3	7	9
5	8	11
1	6	7
2	1	

- A) 2
- B) 3
- C) 6
- D) 8


4. Blerta ka një fugë me numrat nga 1 deri në 16 të shënuar mbi të. Ajo e rrotulloi fugën 24 herë dhe shënoi rezultatin e çdo rrotullimi. Më poshtë jepen rezultatet e përftuara: 2, 1, 4, 7, 9, 10, 2, 6, 5, 8, 3, 11, 7, 6, 3, 3, 12, 14, 8, 8, 7, 1, 15, 16.

4 pikë

a) Ndërtoni një tabelë me denduri të grupuara për të paraqitur këto të dhëna. Përdorni grupet 1 – 4,

5 – 8, 9 – 12 dhe 13 – 16.

b) A mendoni se kjo fugë është e rregullt? Shpjegoni pse?



5. Një punëtor kishte vendosur në bankë një sasi lekësh. Ai tërhoqi nga banka  $\frac{1}{5}$  e lekëve për të

blerë një kostum dhe  $\frac{3}{8}$  e mbetjes për të blerë një telefon. Duke ditur se në bankë i mbetën

1500 lekë, gjeni:

- a) Sasinë e lekëve që kishte punëtori në bankë.
- b) Çmimin e kostumit
- c) Çmimin e telefonit,

6. Mira mendoi një numër. Këtë numër e shumëzoi me 5 dhe pastaj i shtoi 9. Rezultati ishte 44.

Çfarë numri mendoi Mira?

2 pikë

7. Katër fëmijë e përshkruajnë kështu një figurë gjeometrike:

2 pikë

**Joni** thotë: “Figura është një gjashtëkëndësh”.

**Ana** thotë: “Figura ka gjashtë drejtëza simetrie”.

**Teuta** thotë: “Ka të gjitha brinjët të barabarta”.

**Era** thotë: “Ka gjashtë kënde të barabarta”.

**Për cilën figurë bëhet fjalë? Vizatojeni atë.**

8. Zgjidhni alternativën (V) kur fjalia është e vërtetë dhe (G) kur ajo është e gabuar.

4 pikë

A)  $\frac{1}{5} = 50\%$

V	G
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

B)  $0,07 = \frac{7}{10}$

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------

C)  $0,375 = 35\%$

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------

D)  $\frac{3}{4} = 75\%$

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------

9. Lidhni madhësitë me njësitë përkatëse matëse:

6 pikë

B) Masa e një treni

C) Largesa midis dy qyteteve

D) Vëllimi i një shisheje shurup

E) Gjatësia e një fushe futbollli

F) Masa e një makine llogaritëse

G) Vëllimi i ujit në një pishinë

m

l

t

km

ml

g

10. Në fjalitë e mëposhtme vendosni fjalët dhe formulën: **përgjithshme, kuboidit , kubit, S =  $6 \cdot a^2$ , vëllimi, anësore** në mënyrë që fjalia të jetë e saktë. 6 pikë

- a) Syprina e \_\_\_\_\_ e kubit është e barabartë me \_\_\_\_\_ .  
 b) \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ është i barabartë me  $a \cdot b \cdot c$  .  
 c) Syprina \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ është e barabartë me  $4 \cdot a^2$  .

**Klasa VIII, mësuese Arta Mezuri, Vlorë**

1. Shpjego pse ekuacioni  $4(5x + 3) = 2(10x + 6)$  ka një pafundësi zgjidhjesh. (2 pikë/\_\_\_\_)

2. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna për pikët e grumbulluara nga një grup maturantësh në provim.

82	79	87	63	76	98	70	78	65
90	61	85	72	100	75	89	66	73
68	93	80	62	79	64	77	71	88
77	86	69	90	80	100	80	67	85

Klasat	Denduria
61 – 70	
71 – 80	
81 – 90	
91 - 100	

- a) Plotësoni tabelën e dendurive. (1 pikë/\_\_\_\_)  
 b) Cila klasë ka dendurinë më të madhe? (1 pikë/\_\_\_\_)  
 c) Sa është gjerësia e çdo klase? (1 pikë/\_\_\_\_)  
 d) Sa është numri i përgjithshëm i nxënësve? (1 pikë/\_\_\_\_)  
 e) Paraqitni të dhënat në histogram. (1 pikë/\_\_\_\_)

3. Nxënësit e një shkolle, sipas përparimit në mësim, janë kualifikuar në : **A – Të dobët; B – Mesatarë; C – Të mirë; D – Shumë të mirë.** Të dhënat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Paraqit këto të dhëna në diagram rrethor. (3 pikë/\_\_\_\_)

A	B	C	D
15%	45%	30%	10%

4. Plotësoni vendet bosh me fjalën e duhur. (2 pikë/\_\_\_\_)

Dy drejtëza prerëse që formojnë një kënd të drejtë, quhen \_\_\_\_\_. Drejtëza që e ndan segmentin në dy pjesë të barabarta dhe është pingule me segmentin, quhet \_\_\_\_\_ .

5. Vela e varkës së Benit është një kanavacë në formë trekëndëshi me lartësi 15 m dhe gjatësi baze 8 m

a) Gjeni syprinën e velës në  $m^2$ . (1 pikë/\_\_\_)

b) Ai dëshiron të blejë bojë për të lyer velën e tij. 1 litër bojë mbulon  $10 m^2$  sipërfaqe cohë.



Gjeni sa litra bojë duhet të blejë Beni. (1 pikë/\_\_\_)

c) Një kuti bojë nxë 1.5 litra bojë. Sa kuti të tilla do të blejë ai? (1 pikë/\_\_\_)

6.  $v = v_0 + at$

Gjeni vlerën e  $v$  nëse:

a)  $v_0 = 15$ ;  $a = 3$  dhe  $t = 4$  (1 pikë/\_\_\_)

b)  $v_0 = -15$ ;  $a = -3$  dhe  $t = 8$  (1 pikë/\_\_\_)


7. Koeficienti i zmadhimit  $k$  të figurës më poshtë është: (1 pikë/\_\_\_)

A) 2

B)  $\frac{1}{2}$

C) 4

D) 1.5



8. Më poshtë janë vendosur nëpër kuti 4 kufizat e para të 5 vargjeve.

$$a_n = 2n + 3$$

$$a_n = 3n + 2$$

$$a_n = 4n - 3$$

$$a_n = n + 4$$

5, 13, 21, 29...

5, 6, 7, 8...

5, 8, 11, 14...

5, 7, 9, 11...

1, 5, 9, 13...

a) Lidhni vargjet me kufizën e përgjithshme të tyre. (4 pikë/\_\_\_)

b) Gjeni kufizën e përgjithshme për vargun që mbetet. (1 pikë/\_\_\_)

9. 3 metra stof kushtojnë 735 lekë. Gjeni sa kushtojnë 13 metra nga i njëjti lloj stofi.

(1 pikë/\_\_\_\_)


10. Një familje ka 3 fëmijë. Ana, Enkeli dhe Era. Ana është 9 vjeçe, Enkeli është 7 vjeç dhe Era është 4 vjeçe. Ata kanë një shumë parash që duan ta ndajnë në përpjesëtim me moshat e tyre. Ana mori 1250 lekë më shumë se motra e saj Era. Gjeni sa lekë ndanë ata. (2 pikë/\_\_\_\_)

**Klasa VIII, mësuese Dashamira, Berat**

1. Për të mbjellë një tokë bujqësore me sipërfaqe  $1250 \text{ m}^2$  nevojiten 75 kg farë. Sa kg farë nevojiten për të mbjellë një tokë me sipërfaqe  $900 \text{ m}^2$ ? 1 pikë
- A) 48 kg  
B) 24 kg  
C) 54 kg  
D) 72 kg
2. Një kalë është lidhur me litar 10 m të gjatë në njërin skaj (cep) të shtëpisë me përmasa 16 m x 12 m. Sa është syprina maksimale e truallit përreth shtëpisë që ai mund të lëvizë? 1 pikë
- A)  $100\pi \text{ m}^2$   
B)  $90\pi \text{ m}^2$   
C)  $75\pi \text{ m}^2$   
D)  $50\pi \text{ m}^2$
3. Çmimi fillestar i një malli ishte 100 lekë. Tregtari e uli çmimin me 10 % dhe pas një jave e rriti përsëri me 20 %. Sa është çmimi pas një jave? 1 pikë
- A) 100 lekë  
B) 110 lekë  
C) 108 lekë  
D) 130 lekë
4. Maria organizoi një darkë. Ra zilja e parë e derës dhe hynë tre të ftuar. Në çdo zile tjetër vinin dy të ftuar më shumë se herën e mëparshme.
- a) Sa të ftuar hynë në zilen e pestë? 1 pikë  
b) Zbuloj një rregull ndërmjet numrit të ziles dhe numrit të të ftuarve që hyjnë në zilen e n-të. 1 pikë  
c) N.q.s. zilja ka rënë 10 herë, sa të ftuar kanë marrë pjesë në darkën e Marias? 1 pikë

5. Sapuni ka formën e kuboidit me përmasa 2 cm x 4 cm x 8 cm. Çdo ditë nga ai shpenzohet e njëjta sasi. Pas 7 ditëve përsëri ai ka formën e kuboidit por me përmasa 2 herë më të vogla. Për sa ditë do të shpenzohet i gjithë sapuni? 3 pikë
6. Shokët diskutojnë se cili nga dy nxënës është më i mirë në matematikë. Ja notat e tyre:
- Sokoli: 10; 4; 10; 5; 10; 6.
  - Mira: 8; 7; 8; 7.
- a) A janë të sakta pohimet?
- I. Sokoli ka marrë më shumë dhjeta se Mira; 1 pikë
  - II. Sokoli ka marrë më shpesh dhjeta se Mira. 1 pikë
- b) A janë të drejta gjykimet?
- I. Sokoli është më i mirë sepse ka më shumë dhjeta; 1 pikë
  - II. Të dy nxënësit janë njëloj, sepse e kanë të njëjtë mesataren aritmetike. 1 pikë
7. Ndërmjet dy fshatrave A dhe C ka një lumë. Sa është gjerësia e lumit kur janë matur  $AB = 720$  m,  $m(\widehat{BC}) = 41^\circ$ ,  $AA_1 = CC_1 = 20$  m. Vizato figurën me shkallën 1 : 10 000 dhe gjej gjerësinë e lumit.

5 pikë



8. Në një magazinë ka 72 t qepë. Çdo ditë nga ajo marrin 18 t qepë. Sa ton (y) qepë mbetën në magazinë pas x ditësh?
- a) Shprehni me ekuacion varësinë e y nga x. 2 pikë
- b) Çfarë varësie është? Pse? 2 pikë



- c) Të ndërtohet grafiku i tij. 1 pikë
- d) Për cilën pjesë të grafikut ka kuptim problemi? 1 pikë
- e) Gjej në mënyrë algjebrike sa ton qepë mbeten pas 3 ditësh në magazinë? 1 pikë
- f) Përcakto në mënyrë grafike për sa ditë zbrazet magazina? 1 pikë
9. Në një rezervuar kishte 880 t naftë dhe në një tjetër 816 t. Nga rezervuari i parë merren çdo ditë 120 t, ndërsa në të dytin vinin çdo ditë 96 t naftë. Pas sa ditësh në rezervuarin e dytë u grumbullua 3 herë më shumë naftë se në të parin?

**Klasa VIII, mësuese Irena Tafani, shkolla “Naim Frashëri”, Elbasan**

1. Agroni mbajti shënim temperaturën jashtë shtëpisë në mesnatë në ditën e parë të çdo muaji.

11,2°C; - 1,7°C; 3°C; 4.8°C; - 7.3°C; - 0.9°C.

- a) Gjeni mesoren e temperaturave. 1 pikë
- b) Gjeni temperaturën mesatare dhe amplitudën. 2 pikë

2. Tabela paraqet numrin e nxënësve të dy klasave të 8-ta që erdhën me vonesë gjatë një jave.

Ditët e javës	Nr i nx me vonesë (8A)	Nr i nx me vonesë (8B)
E hënë	3	5
E martë	4	4
E mërkurë	3	4
E enjte	0	1
E premte	3	2

- a) Ndërtoni grafikun shtyllë të dy klasave. 1 pikë
- b) Sa është ndryshesa e numrit të nxënësve të 8a me 8b që erdhën me vonesë gjatë një jave? 1 pikë

3. Një fermer ka tri sipërfaqe toke të njëjta në formë katrore me brinjë 6m për kultivimin e perimeve dhe një sipërfaqe katrore me brinjë 8m për kultivimin e frutave.

- a) Shkruani një formulë për të njehsuar syprinën gjithsej duke përdorur fuqitë. 1 pikë
- b) Gjeni syprinën gjithsej. 1 pikë

4. Miri pyeti shokët e tij se sa mesazhe tekst kishin dërguar brenda një dite. Rezultatet janë: 8; 15; 22; 13; 12; 21; 19; 12; 25; 21; 18; 17; 16; 12; 4; 2; 12; 13; 18; 22; 21; 17; 16; 12; 3; 5. Plotësoni tabelën dhe ndërtoni grafikun shtyllë.

Nr i teksteve	Numërimi	Denduria
1-5		
6-10		
11-15		
16-20		
21-25		


- a) Sa shokë pyeti Miri? 1 pikë
- b) Cila është klasa modale? 1 pikë
- c) Sa shokë kishin dërguar më pak se 16 mesazhe tekst? Argumentoni. 1 pikë
5. Mario bleu një makinë që kushtonte 8248 lekë. Ai pagoi në fillim 1975 lekë dhe pastaj 6 këste mujore të barabarta me nga 511 lekë. Sasia e mbetur për t'u paguar është: 1 pikë
- A) 2015 lekë;  
B) 7501 lekë;  
C) 3207 lekë;  
D) 4508 lekë.
6. Një ndërtesë e re do të jetë 65 m e gjatë, 40 m e gjerë dhe 220 m e lartë. Të katër faqet anësore të saj do të jenë me xham dhe jo me tullë.
- a) Gjeni se sa është syprina e sipërfaqes që do të mbyllet me xham. 1 pikë
- b) Çmimi i xhamit është 12800 lekë për metër katror. Gjeni se sa do të kushtojë sasia e xhamit të nevojshëm për ndërtesën. Tregoni se si mund të kontrollohet përfundimi i gjetur duke përdorur një vlerësim. 2 pikë
7. Një pako biskota përmban biskota me fara; biskota me fruta; biskota me çokollatë në raportin 3 : 1 : 4. Pakoja përmban 56 biskota gjithsej. Sa prej biskotave janë:
- a) me fara; 1 pikë
- b) me fruta; 1 pikë

- c) me çokollatë. 1 pikë
8. Një klub kopshtarie përbëhet nga burra, gra, fëmijë në raportin 5 : 4 : 11. Në klubin e kopshtarisë janë gjithsej 2240 pjesëtarë. Sa pjesëtarë të klubit të kopshtarisë janë:
- a) burra; 1 pikë
- b) gra; 1 pikë
- c) fëmijë. 1 pikë

### Klasa IX, mësuese Arta Mezuri, Vlorë

1. Shëno me PO nëse është e vërtetë dhe me JO nëse është e gabuar (3 pikë/\_\_\_)
- Katrori ka dy boshte simetrie PO JO
  - Këndi rrethor që mbështetet në diametër është  $180^\circ$  PO JO
  - Largësia ndërmjet dy drejtëzave paralele është gjithnjë e njëjtë PO JO
  - Shuma e këndeve të njëpasnjëshme me kulm të përbashkët, që formojnë kënd të plotë është  $360^\circ$  PO JO
2. Gjeni sa  $m^3$  ajër ju duhen për të mbushur një dhomë të zbrazët çatia e së cilës është prizëm me bazë trekëndësh dybrinjëshëm.


(3 pikë/\_\_\_)



3. Një punëtori i duhej të punonte një arë si dhe më pas t'a rrethonte atë me tel.

në figurën më poshtë

- a) Sa metër tel i duhet punëtorit për të rrethuar arën? (2 pikë/\_\_\_)
- b) Sa  $m^2$  është ara që ai do të punojë? (2 pikë/\_\_\_)




4. Plotëso tabelën (2 pikë/\_\_\_)

Çmimi i blerjes	Përqindja e fitimit	Çmimi i shitjes
-----------------	---------------------	-----------------


600000	10 %	
50000		75000

5. Sa % të sipërfaqes së rrethit dhe të katrorit të jashtëshkruar rrethit zë figura e ngjyrosur kur dihet se rrethi e ka rrezen 8cm .



(4 pikë/\_\_\_)

6. Një bojaxhi duhej të ngjyoste një mozaik si në figurën më poshtë: katrori brendashkruar rrethit ngjyrë kafe, pjesa e mbetur e rrethit ngjyrë të verdhë dhe pjesa e katrorit jashtëshkruar rrethit ngjyre jeshile. Atij i duhej një 0,5 litër bojë për  $1\text{m}^2$  sipërfaqe. Sa litër bojë i duhet për secilën ngjyrë kur dihet se rrethi e ka rrezen 6 m?



(7

pikë/\_\_\_)

7. Albani mbajti shënim se sa km kishte ecur çdo ditë për 9 ditë me radhë. Të dhënat janë: 11km; 13km; 21km; 23km; 22km; 7km; 52km; 20 km; 21km. Ai mendoi, kam ecur çdo ditë mesatarisht 23km. A ka të drejtë ai? (1 pikë/\_\_\_)
8. Një turist duhej të merrte një makinë me qera. Ai u interesua në dy kompani. Kompania e parë kishte këtë ofertë: ora e parë 600 lekë dhe për çdo orë pasardhëse çmimi rritej me 300lekë. Kompania e dytë kishte këtë ofertë: ora e parë 1000 lekë dhe për çdo orë pasardhëse çmimi rritej me 200lekë.
- a) Cila kompani do t'i leverdiste më mirë turistit nëse makina i duhej vetëm për 3 orë? (1 pikë/\_\_\_)
- b) Cila është lidhja ndërmjet çmimit dhe sasisë së lekëve në secilën kompani? (2 pikë/\_\_\_)

c) Për cilën kohë çmimi i kompanisë së dytë është më i leverdisshëm se ai i kompanisë së parë (bëni paraqitjen grafike për t'iu përgjigjur pyetjes). (2 pikë/\_\_\_)

9. 10 fletore dhe 6 lapsa kushtojnë 130 lekë. Çmimi i një lapsi është 5 lekë. Sa lekë është çmimi i një fletoreje? (1 pikë/\_\_\_)

A) 4 lekë

B) 5 lekë

C) 10

lekë

D) 8 lekë

10. Plotëso: (5 pikë/\_\_\_)

a) Pjesa e një rrethi quhet \_\_\_\_\_

b) Figura e kufizuar nga dy \_\_\_\_\_ dhe një \_\_\_\_\_ quhet sektor qarkor.

c) Syprina e përgjithshme e prizmit është \_\_\_\_\_ e syprinave të \_\_\_\_\_ të tij.

11. Një zotëri depozitoi në bankë për një vit shumën 400000 lekë me përqindje interesi 8,5%.

Fitimi i tij pas një viti do të jetë: (1 pikë/\_\_\_)

A) 24000

B) 34000

C) 28000

D) 32000

12. Pamja plane quhet: (1 pikë/\_\_\_)

A) Pamja ballore

B) Pamja nga lart

C) Pamja anësore

D) Pamja nga mbrapa

13. Ndërto  $\triangle ABC$  në rrjetin koordinativ me kulme:  $A(-4;3), B(-6;1), C(-1;5)$ . (4 pikë/\_\_\_)

a) Kryej zhvendosjen +5 sipas OX dhe -5 sipas OY të trekëndëshit ABC.

b) Kryej simetrinë sipas OX të  $A_1B_1C_1$ .

c) Përcakto shndërrimin që kalon figurën bazë ABC në figurën përfundimtare  $A_2B_2C_2$ .

14. Plotëso :

(4 pikë/\_\_\_\_)

- a) Vargjet në të cilat ndryshesa ndërmjet kufizave pasardhëse dhe paraardhëse është e njëjtë për çdo dy kufiza fqinje të vargut, quhen \_\_\_\_\_.
- b) Shuma e probabiliteteve të ngjarjeve reciprokisht të papajtueshme është \_\_\_\_\_.
- c) Koeficienti këndor i një vije përcakton \_\_\_\_\_ e saj.
- d) Këndi \_\_\_\_\_ quhet këndi që e ka kulmin në rreth dhe brinjët korda të rrethit.

**Klasa IX, mësuese Dashamira, Berat**

1. Dy vetura janë nisur njëkohësisht nga i njëjti vend, por me kahe të kundërta. Pasi kanë kaluar nga 12 km, secila prej tyre ka kthyer në të djathtë dhe kanë vazhduar të lëvizin edhe 5 km. Sa km larg janë tani veturat nga njëra-tjetra? 1 pikë

- A) 20 km
- B) 24 km
- C) 26 km
- D) 34 km

2. Kubi me brinjë 1 m është prerë në kube të vegjël me brinjë 1 dm. Nëse këto kube i vendosim njëri mbi tjetrin, sa do të jetë lartësia e trupit të përftuar në këtë mënyrë? 1 pikë


- A) 1 m
- B) 10 m
- C) 100 m
- D) 1 m

3. Gjashtë rugë A, B, C, D, E dhe F janë të lidhura me rrugë të drejtpërdrejta me njëra-tjetrën. Disa rrugë janë treguar në figurën më poshtë.

Gjej edhe sa rrugë mungojnë?

1 pikë

- A) 6
- B) 7
- C) 8
- D) 9



4. Në një enë ka 5 kg ujë që valon. Në çdo minutë avullon 20 g ujë.

a) Sa ujë do të ketë në enë pas 5, 10, 30 min?

3 pikë

b) Nëse y është sasia e ujit të mbetur pas x minutash, ç'lidhje ekziston ndërmjet x dhe y?

2 pikë

c) Pas sa minutash do të avullojë i gjithë uji që ka ena?

1 pikë

5. Kur shoferi frenon makina nuk ndalon përnjëherë. Gjatësia e rrugës që bën makina pas frenimit quhet largesa e frenimit. Ajo varet nga shpejtësia e frenimit. Formula që lidh largesën e frenimit (d) në metra me shpejtësinë e çastit (v) në km/h është:  $d = 0,01 \cdot v^2$ .

a) Sa m do të rrëshqasë pas frenimit makina që ecën me shpejtësi 60 km/h?

1 pikë

b) Nëse makina rrëshqet 16 m pas frrenimit sa është shpejtësi e çastit?


1 pikë

6. Iliri udhëtoi nga qyteti A për në B. Çerekun e rrugës e ka përshkruar me shpejtësi 50 km/h, kurse pjesën tjetër të saj e ka bërë me shpejtësi 70 km/h. Sa ka qenë shpejtësia mesatare e lëvizjes së tij?

4 pikë

7. Kopshti i një fermeri i mbjellë me perime ka formë drejtkëndore si në figurë. Rruga aktuale që lidh pikën **P** me **R**, kalon sipas diagonales.

Fermeri dëshiron që të ndërtojë një rrugë që lidh pikën **P** me **R** por që të kalojë nga pika **Q**.



a) Gjej gjatësinë e rrugës aktuale.

2 pikë

b) Sa është gjatësia e rrugës së re që do të ndërtojë fermeri?

1 pikë

c) Sa m më e gjatë është ajo e krahasuar me rrugën aktuale?


1 pikë

8. Depoja e një kaldaje kishte 25 t qymyr, ndërsa e një tjetre 22 t. Kaldaja e parë harxhon 75 % më shumë qymyr në ditë se e dyta. Pas 30 ditësh në depon e kaldajës së dytë mbeti 2,5 herë më shumë qymyr se në të parën. Sa qymyr harxhonte secila kaldajë në ditë?

4 pikë

### Klasa IX, mësuese Irena Tafani, shkolla "Naim Frashëri", Elbasan

1. Një kub me gjatësi brinje 5 cm është hequr nga një kub plastik me gjatësi brinje 10 cm.



a) Gjeni vëllimin e pjesës së mbetur.

1 pikë

b) Duke e shkrirë pjesën e mbetur dhe duke e derdhur përsëri, a mund të formoni:

- i. një kub që e ka gjatësinë e brinjës numër të plotë? 2 pikë
- ii. një kuboid që i ka gjatësitë e brinjëve numra të plotë? Tregoni veprimet. 2 pikë
2. Cila është madhësia më e vogël që mund të ketë një tavolinë katrore nëse duhet të mbulohet me një mozaik që kombinon pllakëza katrore me brinjë 2 cm dhe 3 cm? 2 pikë
3. Një agjenci që organizon dasma kërkon një pagesë prej 30 Euro për person për ushqimin dhe një pagesë shtesë për 6 orë me 50 Euro për orë, për qiranë e sallës ku organizohet dasma.
- a) Gjenerali koston gjithsej nëse janë 80 persona. 2 pikë
- b) Shkruani një shprehje për koston gjithsej nëse për ushqim janë  $p$  persona me nga  $x$  Euro për person dhe qiraja është për  $h$  orë me  $y$  Euro për orë. 1 pikë
- c) Shkruani një formulë për koston gjithsej,  $T$ , me anë të  $x$ ,  $p$ ,  $y$  dhe  $h$ . 1 pikë
- d) Përdor formulën tënde për të gjetur  $T$  kur  $x = 35$ ,  $p = 100$ ,  $h = 8$  dhe  $y = 30$ . 2 pikë
4. Një qytet ka 500 000 banorë. Kryetari i bashkisë do të dijë nëse banorët janë të kënaqur me shërbimet që ofron bashkia. Sa e madhe duhet të jetë zgjedhja për anketimin? 1 pikë
- A) 5
- B) 500
- C) 50 000
- D) 5 000

5. Një shkollë ka 2000 nxënës. Drejtori i shkollës do të dijë mendimin e nxënësve për bibliotekën e shkollës. Tregoni një vlerë të përafërt të madhësisë së zgjedhjes që ai duhet të përdorë. 2 pikë

6. Tabela tregon numrin e personave që shkuan në një kafene gjatë 2 javëve.

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
<b>Java 1</b>	10	11	12	12	15	15	15
<b>Java 2</b>	9	10	10	11	15	18	25

- a) Një ditë kafeneja ofroi biskota me gjysmën e çmimit. Cila ditë mendoni se ishte? 1 pikë
- b) Për secilën javë gjenerali:
- i. Mesoren ii. Mesataren iii. Amplitudën.
- c) Cila mesatare është më e mira për të krahasuar dy javët? 1 pikë
7. Fatura e restorantit tregon 6050 lekë + 14% pagesë shërbimi. Sa është vlera gjithsej e faturës duke përfshirë edhe pagesën e shërbimit? 2 pikë
8. Një qendër kopshtesh shet ushqim për zogjtë në kuti cilindrike.




a) Cila nga kutitë është me çmim më të arsyeshëm?

1 pikë

b) Cili është çmimi më i paleverdisshëm?

1 pikë



9. Këtu është një skemë e grafikut të vrapimit të Lilit në mëngjes.




a) Kur vrapon më shpejt ajo?

1 pikë

b) Sa është shpejtësia mesatare e vrapimit të saj?

1 pikë

10. Grafiku tregon çmimin e një makine të përdorur.



a) Vlerësoni çmimin e një makine kur ajo është përdorur 5 vjet.

1 pikë


b) Cilat janë dy vitet gjatë të cilëve çmimi i makinës ndryshon më shumë?

1 pikë

c) Kur e ka makina çmimin sa 50% e makinës së re?

1 pikë

11. Grafiku tregon vlerën e aksioneve të një kompanie gjatë 5 viteve.



- a) Sa ishte vlera e aksioneve në fillim të periudhës 5-vjeçare? 1 pikë
- b) Sa u bë vlera e aksioneve mbas 1 viti? 1 pikë
- c) Sa ishte përqindja e rritjes së vlerës së aksioneve gjatë vitit të parë? Përgjigjja të jepet me afërsinë e një numri të plotë. 2 pikë
- d) Cili vit pati përqindjen e rritjes më të vogël? 2 pikë
- e) Gjeni përqindjen mesatare të rritjes për vit. 2 pikë

**12.** Një zgjedhje e rastit 17-vjeçarësh u anketua për të parë se ç'duan të bëjnë pasi të mbarojnë shkollën. Tabela tregon rezultatet e anketimit.

Gjimnaz	Shkollë profesionale	punë
27	31	17

- a) Sa vetë janë pyetur gjithsej? 1 pikë
- b) Sa përqind zgjedhin gjimnazin? 1 pikë

Një zgjedhje tjetër adoleshentësh dha këto rezultate.

Gjimnaz	Shkollë profesionale	punë
78	65	57

- c) Cila zgjedhje jep një vlerësim më të mirë për probabilitetin që një adoleshent zgjedh një shkollë profesionale? Shpjego përgjigjen tënde. 1 pikë

**13.** Në një klub atletike: 15 anëtarë stërviten të mërkurën; 12 anëtarë stërviten të premten; 10 anëtarë stërviten të mërkurën dhe të premten. Anëtarët e klubit janë: 1 pikë

- A) 17
- B) 27
- C) 37
- D) 47

**14.** Në një video lojë, një krimb i uritur lëviz sipas drejtëzes  $y = 3x + 2$ . Një mollë lëviz sipas drejtëzës  $x = 3$ . Ku do ta hajë krimbi mollën?

2 pikë

### **III. PJESA E TRETË – ARSIMI I MESËM I LARTË**

**Klasa X, Koha 45 min, mësuese Mirjana Canellari, shkolla “Myslym Keta”, Tiranë**

#### **Rezultatet e të nxënit:**

- gjen pjesët dhe përqindjet e sasive të dhëna;
- përcakton për një funksion bashkësinë e përcaktimit, të vlerave, funksionin e anasjellë;

- vërteton pohime duke përdorur algjebren;
- njeh dhe zbaton formula për të njehsuar syprinën e figurave;
- kryen shndërrime të figurave; llogarit probabilitetin e një ngjarjeje duke përdorur parimin e ngjarjeve njëlloj të mundshme, të papajtueshme, të pavaruara.

### Shpërndarja e pikëve sipas nivelit të të nxënit

Njohuritë që kontrollohen	Përqindja	Niveli i I-rë		Niveli i II-të		Niveli i III-të		Gjithsej								
Thyesat, numrat dhjetorë, përqindjet	23%	1 pikë	1	2/b pikë	2	4 pikë	2	8 pikë								
Formulat, funksionet.	30%	2/a pikë	2	3/b pikë	1	5/a pikë	1	6/b pikë	2	11 pikë						
Gjeometria në plan	24%	6/a pikë	2	7 pikë	3	8/a pikë	1	9/a pikë	3	10 pikë	2	8 pikë				
Probabiliteti	23%	9/b pikë	1	11 pikë	1	12/a pikë	2	12/c pikë	1	13/a pikë	1	13/b pikë	1	13/c pikë	1	8 pikë
Pikët në përqindje sipas niveleve		<b>14 pikë = 40% e testit</b>		<b>15 pikë = 40% e testit</b>		<b>8 pikë = 20% e testit</b>		<b>35 pikë</b>								

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 8	9 – 13	14 – 18	19 – 23	24 – 27	28 – 31	32 – 35

1.  $\frac{1}{4}$  e 22 është e barabartë me:

**1 pikë**

A) 5,2

- B) 5,4
- C) 5,6
- D) 5,8

2. Gjeni:


A)  $2,7\bar{5} - 0,2\bar{3} =$  **2 pikë**

B)  $\frac{2\frac{1}{2} - \frac{5}{8}}{1\frac{3}{4} + 2\frac{1}{6}} =$  **2 pikë**

3. Në figurë tregohen një gjashtëkëndësh i rregullt dhe një katror. Qendrat e tyre janë shënuar me pikë.

A) Ç’pjesë e secilës figurë është ngjyrosur? **2 pikë**

B) Në cilën figurë është ngjyrosur pjesa më e madhe? **1 pikë**



4. Liza mbolli me lule 27% të sipërfaqes së kopshtit të saj. Ajo mbuloi me lule 145,8 m<sup>2</sup>.

Sa është syprina e të gjithë kopshtit? **2 pikë**

5.

A) Shkruani formulën sipas pohimit:  $x$  është 2 herë më i madh se shuma e trefshit të  $b$  me 4. **1 pikë**

B) Rishkruani formulën ku subjekt të jetë  $b$ . **1 pikë**

6. Jepen funksionet  $f(x) = 5 - x$  dhe  $g(x) = 3x + 7$ .

A) Gjeni formën e thjeshtuar për  $f(2x) + g(x - 1)$ . **2 pikë**

B) Zgjidhni ekuacionin  $g^{-1}(x) = 2x$ . **2 pikë**

7. Thjeshtoni thyesën:  $\frac{9 - x^2}{3x^2 - 5x - 12}$ . **3 pikë**

8. Për funksionin:  $y = \sqrt{8x + 2}$ . Bashkësia e:

a. përcaktimit të funksionit është: **1 pikë**

H)  $\left[-\frac{1}{4}, +\infty\right[$

I)  $\left]-\frac{1}{4}, +\infty\right]$

J)  $\left]-\infty, -\frac{1}{4}\right]$

K)  $\left]-\infty, -\frac{1}{4}\right[$

b. vlerave të funksionit është:

**1 pikë**

A)  $]-\infty, +\infty[$

B)  $]-\infty, 0]$

C)  $[0, +\infty[$

D)  $]0, +\infty]$


9. Paralelogrami dhe trekëndëshi në figurë kanë lartësi dhe syprinë të njëjtë. Gjeni

A) gjatësinë e bazës së trekëndëshit.

**3 pikë**


B) perimetrin e paralelogramit

**1 pikë**



10. Përshkruaj shndërrimin e vetëm të figurës P në figurën Q.

**2 pikë**



11. Probabiliteti që një

është  $\frac{11}{20}$ . Sa është

pikën?

lojtar tenisi të shënojë një pikë

probabiliteti që ai të humbë

**1 pikë**

12. Një zar është hedhur dy herë. Sa është probabiliteti i ngjarjes:

a. diferenca e pikëve të rëna është 4;

**2 pikë**

b. diferenca e pikëve të rëna është jo më e madhe se 3. **1 pikë**

c. të dy zaret tregojnë të njëjtin numër. **1 pikë**

**13.** Në një çantë ka 3 sfera të gjelbra, 6 sfera blu dhe 7 sfera të zeza. Tërheqim rastësisht një sferë nga çanta. Sa është probabiliteti që sfera e nxjerrë të jetë:

A) E zezë? **1 pikë**

B) Jo blu? **1 pikë**

C) E kuqe? **1 pikë**

### **Klasa XI, Koha 45 min, mësuese Mirjana Canellari, shkolla “Myslym Keta”, Tiranë**

#### **Rezultatet e të nxënit:**

- kryen veprime që përmbajnë rrënjë dhe fuqi (edhe me eksponent negativ dhe racional);
- ndërton dhe interpreton grafikë të funksioneve të ndryshme;
- njeh dhe zbaton teoremat e Pitagorës dhe Euklidit për të gjetur gjatësinë e një brinje në një trekëndësh kënddrejtë;
- zbaton formulat trigonometrike bazë për të gjetur kënde dhe gjatësi në trekëndëshin kënddrejtë;
- zbaton teoremat e sinusit dhe kosinusit në trekëndëshin e çfarëdoshëm, për të gjetur gjatësi dhe kënde të panjohura;
- zbaton mbledhjen dhe zbritjen e vektorëve si dhe shumëzimin e vektorit me një numër; zbaton paraqitjen gjeometrike të vektorit si edhe paraqitjen në shtyllë me anë të koordinatave.

#### **Shpërndarja e pikëve sipas nivelit të të nxënit**


<b>Njohuritë që kontrollohen</b>	<b>Përqindja</b>	<b>Niveli i I-rë</b>		<b>Niveli i II-të</b>		<b>Niveli i III-të</b>		<b>Gjithsej</b>
<b>Veprimet me numra 2</b>	22%	1	1 pikë	3	2 pikë	5	2 pikë	8 pikë
		2	1 pikë	4/b	1 pikë			
		4/a	1 pikë					
<b>Grafikët 2</b>	38%	6/a	2 pikë	6/c	2 pikë	8/b	2 pikë	13 pikë
		6/b	2 pikë	6/d	2 pikë			
		8/a	1 pikë	7	2 pikë			
<b>Teorema e Pitagorës, trigonometria dhe vektorët</b>	40%	10/a	2 pikë	9	3 pikë	11	3 pikë	14 pikë
		10/b	2 pikë	12/b	2 pikë			
		12/a	2 pikë					
<b>Pikët në përqindje sipas niveleve</b>		14 pikë = 40% e testit		14 pikë = 40% e testit		7 pikë = 20% e testit		35 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
------	---	---	---	---	---	---	----

Pikët	0 – 8	9 – 13	14 – 18	19 – 23	24 – 27	28 – 31	32 – 35
-------	-------	--------	---------	---------	---------	---------	---------

1. Vlera e shprehjes  $9^{\frac{1}{6}} : 9^{\frac{2}{3}} \cdot 3^{\frac{1}{4}}$  është e barabartë me: **1 pikë**
- A) 5  
B) 5  
C) 5  
D) 5
2.  $(5^{-3})^{-2} \cdot 25^{\frac{1}{2}} =$  **1 pikë**
- A)  $5^{-4}$   
B)  $5^{-3}$   
C)  $5^6$   
D)  $5^7$
3. Masa e tokës është  $5,97 \cdot 10^{24}$  kg. Vëllimi i tokës është  $1,08 \cdot 10^{21}$  m<sup>3</sup>. Gjeni me saktësi dendësinë e tokës. **2 pikë**
4. Nëse  $2^m = 32$  dhe  $9^p = 3^m$ , gjeni:
- a. vlerën e m, **1 pikë**  
b. vlerën e p. **1 pikë**
5. Zgjidhni ekuacionin:  $\sqrt{5}(\sqrt{8} + \sqrt{18}) = x\sqrt{10}$  **2 pikë**
- 6.
- a. Skiconi grafikun e funksionit  $f(x) = x^3 - 3x + 1$  për  $-2 \leq x \leq 2$ . **2 pikë**





b. Gjeni me anë të grafikut rrënjët e funksionit.

**2 pikë**

7. Në të njëjtin sistem koordinativ, duke argumentuar shndërrimin, ndërtoni grafikët e funksioneve:

c.  $y = f(x) - 2$


**2 pikë**

d.  $y = f(x - 1)$

**2 pikë**

8. Në figurë jepët grafiku i funksionit  $y = x^2 - x + 2$ . Gjeni syprinën e zonës së kufizuar nga vija , boshti Ox dhe drejtëzat  $x = 1$  dhe  $x = 3$ .

**2 pikë**



9. Jepet rrethi me ekuacion  $x^2 + y^2 = 80$ . Le të jetë  $P(-4 ; y)$  pikë e rrethit me ordinatë pozitive.

a. Koordinatat e pikës P janë:

1 pikë

A.  $P(-4 ; -8)$

B.  $P(-4 ; -6)$

C.  $P(-4 ; 8)$

D.  $P(-4 ; 6)$


b. Gjeni ekuacionin e tangjentes me rrethin në pikën P.

2 pikë

10. Trekëndëshi në figurë është kënddrejtë dhe të gjitha përmasat janë në centimetra. Gjeni

vlerën e raportit  $\frac{x}{y}$ .

3 pikë



11. Një antenë televizive është 300 m e lartë. Antena lidhet me kablo nga maja e shtyllës në tokë. Këndi ndërmjet secilës kablo dhe tokës është  $60^\circ$ .

a. Sa e gjatë është secila kablo?

2 pikë

b. Sa e gjatë është largesa horizontale ndërmjet fundit të kablos të lidhur në tokë dhe bazës së antenës.

2 pikë

12. Nga një port P, një anije lundron 46 km me një kurs  $104^\circ$  dhe më pas lundron 32 km me një kurs  $310^\circ$ . Llogaritni largesën dhe kursin e anijes nga P, pas këtij udhëtimi.

3 pikë

13. Jepen vektorët paralelë  $\vec{a} = \begin{pmatrix} 6 \\ -10 \end{pmatrix}$ ;  $\vec{b} = \begin{pmatrix} -1 \\ 2 \end{pmatrix}$  dhe  $\vec{c} = \begin{pmatrix} -4 \\ 7 \end{pmatrix}$ .

a. Gjeni  $2\vec{a} + \vec{b} - 3\vec{c}$ .

2 pikë

b. Tregoni që vektori  $\vec{a} + 2\vec{c}$  është paralel me vektorin  $\vec{b}$ .

2 pikë

**Klasa XII, Koha 45 min, mësuese Mirjana Canellari, shkolla “Myslym Keta”, Tiranë**

**Rezultatet e të nxënit:**

- shpreh vektorë të ndryshëm me ndihmën e koordinatave dhe kryen veprime me vektorë;
- zgjidh situata problemore gjeometrike në plan, me anë të metodave vektoriale;
- gjen gjatësinë dhe drejtimin e një vektori;
- lexon dhe interpreton të dhënat e një studimi të paraqitur me ndihmën e një grafiku me kuti apo histogram;
- interpreton të dhënat duke përdorur karakteristikat e shpërndarjes dhe të pozicionit;
- zgjidh situata problemore në lidhje me probabilitetin e ngjarjeve të pavarura, të papajtueshme, të kundërta;
- përdor funksionin probabilitar për të gjetur shpërndarjen e probabiliteteve.

**Shpërndarja e pikëve sipas nivelit të të nxënit**

Njohuritë që kontrollohen	Pesha	Niveli i I-rë		Niveli i II-të		Niveli i III-të		Gjithsej
<b>Vektorët</b>	25%	1/a 1/b 2/a	1 pikë 2 pikë 1 pikë	3	3 pikë	2/b	2 pikë	9 pikë
<b>Mbledhja, paraqitja dhe interpretimi i të dhënave</b>	42%	4/a 4/b 4/c 6/b	1 pikë 1 pikë 2 pikë 2 pikë	4/d 5/b 6/a	2 pikë 2 pikë 2 pikë	5/a	3 pikë	15 pikë
<b>Probabiliteti dhe ndryshoret diskrete të rastit</b>	33%	7/a 7/c	2 pikë 2 pikë	6/c 7/b	2 pikë 3 pikë	8	2 pikë	11 pikë
<b>Pikët në përqindje sipas niveleve</b>		14 pikë = 40% e testit		14 pikë = 40% e testit		7 pikë = 20% e testit		35 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 8	9 – 13	14 – 18	19 – 23	24 – 27	28 – 31	32 – 35

1. Jepen vektorët  $\vec{a} = \begin{pmatrix} 2 \\ -5 \end{pmatrix}$  dhe  $\vec{b} = \begin{pmatrix} 3 \\ -4 \end{pmatrix}$ .

a. Gjatësia e vektorit  $|\vec{a}|$  është:

**1 pikë**

A) 7

B) 9

C)  $\sqrt{21}$

D)  $\sqrt{29}$

b. Njehsoni vektorin njësi  $\vec{b}_0$  të vektorit  $\vec{b}$

**2 pikë**

2. Janë dhënë vektorët  $\vec{a} = \begin{pmatrix} -3 \\ 8 \end{pmatrix}$  dhe  $\vec{b} = \begin{pmatrix} 2 \\ 1 \end{pmatrix}$ . Dihet që  $|\vec{a} + k\vec{b}| = \sqrt{82}$ . Gjeni:

a. vektorin  $\vec{a} + k\vec{b}$

**1 pikë**

b. vlerat e mundshme për k.

**2 pikë**

3. Pikat P, Q, R, S kanë përkatësisht rrezevektorë  $\vec{p} = \begin{pmatrix} 6 \\ 3 \end{pmatrix}$ ;  $\vec{q} = \begin{pmatrix} -3 \\ -5 \end{pmatrix}$ ;  $\vec{r} = \begin{pmatrix} 1 \\ -3 \end{pmatrix}$ ;  $\vec{s} = \begin{pmatrix} 10 \\ 5 \end{pmatrix}$ .

Tregoni që katërkëndëshi PQRS është paralelogram.

**3 pikë**

4. Tabela jep disa informacione rreth kilometrave për orë të 60 kamionëve.

Km/orë	Denduria		
$40 < x \leq 50$	6		
$50 < x \leq 60$	16		
$60 < x \leq 70$	28		
$70 < x \leq 80$	10		

Plotësoni fjalitë:

a. Klasa modale për këto të dhëna është \_\_\_\_\_, sepse ka \_\_\_\_\_.

**1 pikë**

b. Klasa që përmban mesoren është \_\_\_\_\_, sepse mesorja është vlera e \_\_\_\_\_.

**1 pikë**

Gjeni :

c. një vlerë të përafërt për mesataren në km/orë.

**2 pikë**

d. sa përqind e kamionave kanë shpejtësi më të madhe se mesatarja e përafërt.

**2 pikë**


5. Histogrami i paraqitur tregon informacion rreth lartësisë në metra të 81 pemëve.

a. Gjeni numrin e pemëve që përfaqëson shtylla e parë.


**3 pikë**

b. Ç'pjesë e pemëve janë të larta më shumë se 4 metra?

**2 pikë**



6. Grafiku me kuti më poshtë tregon diametrin në milimetra të 60 domateve të një lloj varieteti.



- a. Gjej sa % e domateve e kanë diametrin më tepër se 35 mm? **2 pikë**
  - b. Gjeni mesoren dhe ndryshesën ndërkuartilore. **2 pikë**
  - c. Nëse zgjedh rastësisht 1 domate, sa është probabiliteti që diametri i saj të jetë më tepër se 35 m dhe më pak se 44 mm? **2 pikë**
7. Në një kuti ndodhen 4 sfera të bardha dhe 3 sfera të zeza. Nxjerrim nga kutia një sferë dhe pasi i shohim ngjyrën e fusim përsëri në kuti. Më pas nxjerrim nga kutia përsëri një sferë.
- a. Ndërtoni diagramën pemë të këtij eksperimenti. **2 pikë**
  - b. Gjeni shpërndarjen e ndryshores së rastit  $X$ : “Numri i sferave të bardha të nxjerra nga kutia”. **3 pikë**
  - c. Të gjendet  $P(X \leq 1)$ . **2 pikë**
8. Në një çantë janë 18 sfera me ngjyrë të kuqe ose të bardhë ose blu ose të verdhë. Goni do të nxjerrë në mënyrë të rastësishme një sferë nga çanta. Tabela tregon secilin prej probabiliteteve që sfera e nxjerrë do të jetë blu ose do të jetë e verdhë.

Ngjyra	e kuqe	e bardhë	blu	e verdhë
Probabiliteti			0,45	0,25

Probabiliteti që sfera e nxjerrë të jetë e kuqe është sa dyfishi i probabilitetit që sfera e nxjerrë të jetë e bardhë. Gjeni numrin e sferave të kuqe në qese. **2 pikë**